

# DORACAK PËR

**KËSHILLAT  
RINORE  
LOKALE**

# DORACAK

për

**KËSHILLAT RINORE LOKALE**

**Titulli:** Doracak për këshillat rinore lokale

**Redaktore:** Jasmina Todorovska-Miteva nga Misioni i OSBE-së në Shkup

**Autorë/e:**

Jasmina Todorovska-Miteva dhe Nina Shulloviç-Cvetkovska  
nga Misioni i OSBE-së në Shkup

Dona Kosturanova, Blazhen Maleski, Tomislav Gajtanoski, Lindita Rexhepi,  
Matej Manevski, Zoran Ilieski - konsulentë të pavarur

**Bashkëpunëtorë/e:**

Mirije Sulmati dhe Goran Tanevski  
nga Misioni i OSBE-së në Shkup

**Botues:** Agjencia për Rini dhe Sport dhe Misioni i OSBE-së në Shkup

**Përkthimi dhe lektura:** Bestel

**Dizajni grafik dhe shtypja:** Polyesterday



Përmbajtja e këtij publikimi nuk përfaqëson medoemos këndvështrimet apo qëndrimet e Misionit të OSBE-së në Shkup.

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përmbajtja e këtij publikimi mund të përdoret dhe riprodhohet lirshëm për qëllime arsimore dhe qëllime të tjera jotregtare, me kusht që Agjencia për Rini dhe Sport e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Misioni i OSBE-së në Shkup të ceken si burime për çdo riprodhim të tillë.

Dëshirojmë të shprehim mirënjohjen tonë për të gjithë ata që morën pjesë në përgatitjen dhe hartimin e këtij doracakut, si dhe ish-deputetes Ivana Tufekxhiç, në rolin e koordinatores së Grupit Punues për Ligjin për Pjesëmarrjen Rinore dhe Politikën Rinore, e po ashtu dhe anëtarëve dhe anëtareve të tjerë/a të grupit të punës: Gjorgi Tasev, Këshilltar Special për të Rinjtë dhe Politikën Rinore i Kryeministrit të RMV-së; Milan Zhivkoviç, Këshilltar Special për Punën dhe Politikën Sociale i Kryeministrit të RMV-së; Dushica Perishiç, Drejtore Ekzekutive e BNJVL-së; dhe ish-Drejtorëve të ARS-së: Marjan Spaseski dhe Darko Kaevski; dhe ish zyrtarëve të ARS-së: Zorica Stamenkovska, Ana Manasieva dhe Evgenija Janakieska për mbështetjen e shprehur, besimin, sugjerimet dhe këshillat e dobishme për përgatitjen e këtij doracakut.



Të rinjtë janë ata që i bëjnë ndryshimet dhe që e çojnë shoqërinë përpara. Ndërtimi i shoqërive demokratike, gjithëpërfshirëse dhe përparimtare fillon me të rinjtë dhe ata duhet të përfshihen në mënyrë aktive në të gjitha sferat e veprimit shoqëror.

Ligji për Pjesëmarrjen e të Rinjve dhe Politikat Rinore përcakton për herë të parë në vend kategorinë e të rinjve, format e organizimit të rinisë dhe pjesëmarrjen e të rinjve, si në nivelin kombëtar ashtu edhe në atë lokal. Të gjitha politikat për të rinjtë, idetë dhe zgjidhjet, që synojnë të krijojnë një standard më të mirë jetese për të rinjtë, do të vazhdojnë të miratohen së bashku me të rinjtë në një proces transparent dhe gjithëpërfshirës.

Këshillat rinore lokale do të jenë zëri i të rinjve dhe përmes tyre ata do të kenë mundësinë të fillojnë dialog me autoritetet lokale dhe të diskutojnë hapur çështjet, problemet dhe interesat e të rinjve.

Agjencia për Rini dhe Sport do të vazhdojë të jetë mbështetja më e madhe institucionale për të rinjtë dhe një partner në krijimin e një shoqërie të përshtatur për ta, ku ata do të mund të rrisin kapacitetin e tyre, të jenë aktivë dhe të jenë nxitës të proceseve shoqërore.

Si Agjenci për Rini dhe Sport, ne vazhdojmë të mbështesim dhe t'i hapim dyert që të dëgjohet dhe të respektohet zëri i të rinjve për të ardhmen e tyre dhe për të ardhmen e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Të rinjtë me idetë e tyre të guximshme dhe novatore, marrin pjesë aktivisht në ndërtimin e një shoqërie moderne, demokratike, progresive dhe të barabartë për të gjithë dhe ata duhet të qëndrojnë korrigjues vigjilentë të çdo qeverie.

Do të doja t'ju falënderoj për mbështetjen e vazhdueshme që e ka dhënë Misioni i OSBE-së në Shkup për zhvillimin e sektorit të rinisë dhe për inkurajimin e pjesëmarrjes së të rinjve dhe unë jam vërtet i kënaqur që bashkëpunimi i shkëlqyeshëm rezultoi me krijimin e këtij doracaku që do të jetë një mjet dhe udhëzues i dobishëm për të rinjtë, anëtarët e këshillave rinore lokale, kryetarët e komunave, komunat, nëpunësit administrativë dhe format rinore të organizimit me qëllim të krijimit të këshillave funksionale dhe aktive rinore lokale, përmes të cilave do të ndërtohen komunitete të përshtatura me nevojat e të rinjve.

**Naumçe Mojsovski,**  
Drejtor i Agjencisë për Rini dhe Sport



Të rinjtë janë bartës të rëndësishëm të ndryshimit në çdo shoqëri. Akti Përfundimtar i Helsinkit i vitit 1975, si dokument themelues i OSBE-së, e nënvizon rolin pozitiv të grave dhe burrave të rinj që i çon shoqëritë drejt një sigurie gjithëpërfshirëse. Në vitet e fundit, është zhvilluar një konsensus që të rinjtë duhet të kenë një vend në tryezë kur diskutohen çështjet që i prekin ata.

Forcimi i pjesëmarrjes dhe angazhimit të të rinjve; duke punuar me dhe për të rinjtë; krijimi i mundësive për integrimin e perspektivave të të rinjve në dialogun për politikatat janë fusha prioritare për

kryesuesit aktualë dhe të ardhshëm të OSBE-së

Ne, në Misionin e OSBE-së në Shkup, gjithashtu punojmë në mënyrë aktive në këtë fushë, duke mbështetur qeverinë, autoritetet komunale dhe organizatat rinore për të gjetur mënyra për të rritur pjesëmarrjen dhe angazhimin e të rinjve.

Së bashku me Agjencinë për Rini dhe Sport, një nga palët tona kryesore të interesit, jam i kënaqur t'ju prezantoj këtë doracak për këshillat rinore, duke besuar se ai është një burim i dobishëm dhe praktik, si për të rinjtë ashtu edhe për zyrtarët komunalë.

Ambasadori **Klemens Koja**,  
Shef i Misionit të OSBE-së në Shkup



# HYRJE


Ky doracak është dedikuar për anëtarët e rinj të këshillave rinore lokale dhe punonjësit e komunave dhe shërben si një udhëzues për krijimin dhe funksionimin e këshillave rinore lokale. Doracaku përfshin këshilla praktike, hapa, por edhe rekomandime se si të themelohet një këshill funksional rinor në komunat në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Procesi i hartimit të këtij doracaku filloi në vitin 2017 si një aktivitet i përbashkët i Agjencisë për Rini dhe Sport dhe i Misionit të OSBE-së në Shkup. Kur filloi përgatitja e këtij doracaku, qëllimi ishte që ai të rekomandojë një qasje të unifikuar për mënyrën e formimit, funksionimit, zgjedhjen e anëtarëve të këshillave rinore lokale, mandatin e tyre, fushëveprimin e punës së anëtarëve të këshillave rinore lokale, si dhe pranim-dorëzimin e gjithë punës së anëtarësisë në largim, te anëtarësia e sapo zgjedhur. Për këtë qëllim, përveç përvojës së autorëve në punën me këshillat rinore lokale që tashmë ishin formuar në disa komuna në periudhën e kaluar, Misioni i OSBE-së në Shkup në vitin 2017, zhvilloi vizita në terren në dyzet komuna së bashku me autorët e këtij doracaku në mënyrë që të identifikojnë praktikrat e mira, por edhe sfidat në funksionimin e KRL-ve tashmë të krijuara (për shembull, në disa KRL mandati i anëtarëve ishte katër vjet, e në disa të tjera dy vjet). Në ndërkohë, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut e miratoi Ligjin për Pjesëmarrjen e të Rinjve dhe Politikat Rinore në janar të vitit 2020. Doracaku për këshillat rinore lokale është në përputhje me Ligjin për Pjesëmarrjen e të Rinjve dhe Politikat Rinore me atë që autorët kanë rishikuar dhe përshtatur përmbajtjen e mëparshme të doracakut gjatë vitit 2020.

Mbështetja e pjesëmarrjes së të rinjve në zhvillimin e politikave efektive rinore dhe në vendimmarrje së bashku me institucionet, është e rëndësishme për të siguruar një jetë më të mirë për të rinjtë dhe për forcimin e kapacitetit demokratik të komunitetit të tyre. Të rinjtë duhet të jenë aktivë dhe të angazhuar sepse ne e shohim pjesëmarrjen e tyre si pjesë e zgjidhjeve për një botë më të mirë dhe më të sigurt!

Këshilli Rinor Lokal për shumë komuna është një sfidë e re që synon të rrisë pjesëmarrjen e të rinjve në komunë dhe në komunitetin lokal. Njohja e nevojave dhe sfidave të të rinjve, zgjidhja e tyre, në bashkëpunim me vetë të rinjtë dhe ofrimi i shërbimeve të përshtatshme për të rinjtë, e inkurajon përparimin dhe zhvillimin e të rinjve dhe e forcon rolin e tyre brenda shoqërisë. Format rinore të organizimit janë të pranishme në shumë komuna të vendit dhe kanë njohuri dhe përvojë adekuate në fushën e politikave rinore. Kjo është arsyeja pse është e nevojshme që komunat duhet t'i përfshijnë ata në procesin e krijimit dhe transformimit të këshillave rinore lokale, por edhe në funksionimin dhe punën e tyre në të ardhshmen, si dhe në proceset e vendimmarrjes.

Për funksionimin e suksesshëm të këshillave rinore lokale, është e rëndësishme të merren parasysh nevojat specifike, kërkesat dhe interesat e të rinjve nga mjedisi lokal. Prandaj, secila komunë duhet ta përshtatë këtë proces me nevojat reale të të rinjve dhe karakteristikat e



qenësishme të mjedisit lokal, dhe të inkurajojë pjesëmarrjen e të rinjve pavarësisht nga gjinia, përkatësia etnike, orientimi politik. Nga ana tjetër, të rinjtë duhet t'i përfaqësojnë interesat dhe nevojat e përbashkëta për situatat dhe sfidat që janë në interesin e tyre, në mënyrë që të ndërtojnë një shoqëri më të mirë. Këshilli Rinor Lokal si organ aktiv duhet të jetë në funksion të të rinjve dhe t'i përfaqësojë interesat e tyre. Komuna gjithashtu duhet të sigurojë mbështetje nga ana e administratës dhe nga Këshilli komunal në krijimin dhe funksionimin e Këshillit Rinor Lokal.

Krijimi i një Këshilli Rinor Lokal do të kontribuojë në përfshirjen e të rinjve në proceset e hartimit të politikave në nivelin lokal, përmirësimin e pozitës së tyre në komunitet dhe ndërtimin e kapacitetit të të rinjve si udhëheqës të ardhshëm në shoqëri. Nga ana tjetër, për vetë të rinjtë ky do të jetë një hap motivues për të praktikuar qytetari aktive, për të marrë pjesë në zgjidhjen e problemeve të të rinjve të komunës dhe për të punuar në ndërtimin e një të ardhme më të mirë në mjedisin lokal për të gjithë qytetarët.

Ky manual bazohet në përvojat e grumbulluara, njohuritë dhe mësimet e marra nga organizimi i deritanishëm i të rinjve vendas dhe bazohet në Ligjin për Pjesëmarrjen e të Rinjve dhe Politikën Rinore, në mënyrë që të lehtësojë zbatimin dhe kuptimin e tij, si dhe për të mbështetur pjesëmarrjen e të rinjve në nivelin lokal. Kur hapat e punës nuk janë përcaktuar në ligj ose në aktet nënligjore ekzistuese, autorët e këtij doracaku i plotësojnë ato me rekomandime të përcaktuara në bashkëpunim me Agjencinë për Rini dhe Sport, për të dhënë një pasqyrë dhe udhërrëfyes më të qartë për formimin dhe punën e këshillave të ardhshëm rinore lokale.





# PËRMBAJTJA

Shkurtesat . . . . .	10
Fjalor . . . . .	11

## **1. POLITIKA RINORE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT . . . . . 14**

1.1 Korniza ligjore . . . . .	14
1.2 Korniza strategjike . . . . .	16
1.3 Barazia gjinore në RMV . . . . .	18
1.4 Përfshirja e pjesëmarrjes së të rinjve . . . . .	19
1.5 Udhëzimet dhe standardet evropiane për politikat rinore . . . . .	20
1.6 Pjesëmarrja e të rinjve . . . . .	22
1.7 Politika rinore . . . . .	23

## **2. KËSHILLAT RINORE LOKALE . . . . . 24**

2.1 Roli i Këshillit Rinor Lokal . . . . .	24
2.2 Struktura e Këshillit Rinor Lokal . . . . .	25
2.3 Hapat për formimin e një Këshilli Rinor Lokal . . . . .	27
2.4 Çfarë në rast se komuna ka tashmë një Këshill Rinor Lokal? . . . . .	32
2.5 Formimi i ekipit dhe konsultimi . . . . .	35

<b>PËRFITIMET NGA KËSHILLAT RINORE LOKALE . . . . .</b>	<b>36</b>
Përfitimet për komunën . . . . .	37
Përfitimet për të rinjtë . . . . .	37

## **3. PUNA E KËSHILLAVE RINORE LOKALE . . . . . 38**

3.1 Kompetencat e komunave që dalin nga Ligji për Pjesëmarrjen e të Rinjve dhe Politikat Rinore . . . . .	41
3.1.1 Nëpunësi/ja për të rinjtë . . . . .	41
3.1.2 Zyra për të rinjtë . . . . .	43



3.1.3 Njohja me komunën dhe trajnimet për Këshillin Rinor Lokal . . . . .	43
3.1.4 Strategjia Lokale për të Rinjtë . . . . .	44
3.1.5 Financimi . . . . .	45
3.2 Fusha e veprimit të Këshillit Rinor Lokal në lidhje me komunën dhe të rinjtë . . . . .	46
3.2.1 Seancat dhe takimet e rregullta të Këshillit Rinor Lokal . . . . .	46
3.2.2 Krijimi i programit vjetor . . . . .	47
3.2.3 Organizimi i konsultimeve me të rinjtë në komunë dhe mbledhjet për informim. . . .	48
3.2.4 Konsultimet me Kuvendin Lokal të të Rinjve . . . . .	48
3.2.5 Konsultimet me të rinjtë . . . . .	49
3.2.6 Prania në seancat e Këshillit të komunës . . . . .	49
3.2.7 Përgatitja e propozimeve dhe iniciativave për kryetarin/en e komunës dhe/ose kryetarin/en e Këshillit . . . . .	50
3.2.8 Inkluziviteti në Këshillin Rinor Lokal . . . . .	50
3.2.9 Raporti vjetor . . . . .	53
3.2.10 Përfundimi i mandatit dhe procesi i pranimit-dorëzimit nga anëtarësia e vjetër tek anëtarësia e re . . . . .	53
3.2.11 Vetëvlerësimi: A është i suksesshëm Këshilli Rinor Lokal? . . . . .	54
3.3 Transparenca në punën e Këshillit Rinor Lokal . . . . .	55
3.3.1 Përkufizimi dhe qëllimet e marrëdhënieve me publikun . . . . .	56
3.3.2 Prania në internet . . . . .	56
3.3.3 Ngjarjet publike . . . . .	57
3.3.4 Mediat sociale dhe mjetet e komunikimit në internet . . . . .	57
<b>4. LITERATURA E PËRDORUR . . . . .</b>	<b>59</b>
<b>5. SHTOJCA . . . . .</b>	<b>60</b>













# 1. POLITIKA RINORE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

## 1.1 Korniza ligjore

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut për një kohë të gjatë nuk kishte asnjë kornizë ligjore që e rregullon organizimin e të rinjve, pjesëmarrjen e të rinjve, si dhe politikat rinore në nivelin kombëtar dhe lokal. Në janar të vitit 2020, u miratua për herë të parë Ligji për Pjesëmarrjen e të Rinjve dhe Politikat Rinore ("Gazeta Zyrtare e RMV-së", nr. 10/2020). Me këtë ligj, të rinjtë kanë siguruar një kornizë ligjore dhe mekanizma që e garantojnë pjesëmarrjen e tyre në krijimin e politikave që i prekin ata.


Qëllimi i Ligjit për Pjesëmarrjen e të Rinjve dhe Politikat Rinore (LPRPR) është të sigurojë krijimin dhe zbatimin e politikave rinore në të gjitha nivelet përmes një qasjeje multi-sektoriale të udhëhequr nga nevojat dhe interesat e të rinjve. LPRPR-ja synon të forcojë pjesëmarrjen e të rinjve në proceset e vendimmarrjes, si dhe krijimin e politikave për të rinjtë, informimin aktiv, promovimin dhe mbrojtjen e interesave të të rinjve, forcimin e vetëdijes për rëndësinë e të rinjve dhe rolin e tyre shoqëror. Ligji synon gjithashtu të promovojë partneritete ndërmjet brezave për të mbështetur pjesëmarrjen e të rinjve në procesin e vendimmarrjes dhe hartimit të politikave, dhe për të mbështetur dhe avancuar organizimin e të rinjve, duke nxitur një dialog të strukturuar në nivelin kombëtar dhe lokal. Inkurajimi i vullnetarizmit, aktivizmit rinor dhe punës së të rinjve me qëllim inkurajimin e zhvillimit personal, profesional dhe social të të rinjve është gjithashtu një qëllim i rëndësishëm i ligjit. Organi kompetent për implementimin e LPRPR-së është Agjencia për Rini dhe Sport.<sup>2</sup>

Në LPRPR, kufiri i moshës së të rinjve përcaktohet prej 15-29 vjeç. Format e organizimit të të rinjve në LPRPR rregullohen si: organizatë për të rinjtë, organizatë rinore dhe organizatë ombrellë rinore; ndërsa LPRPR-ja njih gjithashtu forumet rinore të partive politike, organizata të nxënësve dhe të studentëve dhe format e tjera të organizimit të të rinjve. LPRPR-ja e njih punën e të rinjve dhe përcakton punonjësin me të rinjtë.

LPRPR-ja është neutral në aspekt gjinor dhe bazohet në tetë parime,<sup>3</sup> gjegjësisht në parimet e barazisë, ndalimit të diskriminimit, multikulturalizmit, interkulturalizmit dhe gjithpërfshirjes në pjesëmarrjen aktive të të rinjve, përfshirjen ndëretnike, përgjegjësinë dhe solidaritetin midis të rinjve, si dhe bashkëpunimin ndërinstucional në krijimin dhe zbatimin e politikave rinore.

2 Agjencia për Rini dhe Sport (<http://www.ams.gov.mk/>)

3 Ligji për Pjesëmarrjen e të Rinjve dhe Politikat Rinore (Gazeta zyrtare e RMV-së, nr. 10/2020), nen 5



RMV-ja shprehu qartë vendosmërinë dhe përcaktimin e saj për t'u kujdesur për nevojat dhe interesat e të rinjve në nivelin kombëtar dhe lokal, si dhe për të integruar të rinjtë në proceset e vendimmarrjes. Kështu, LPRPR-ja e detyron Qeverinë të krijojë një Organ Këshillimor Kombëtar për Politikat Rinore, ku të rinjtë së bashku me përfaqësuesit e organeve kompetente do të kenë një rol këshillues, por edhe mbikëqyrës, në zbatimin e politikave dhe aktiviteteve kombëtare për të rinjtë.

Qeveria është e detyruar të miratojë Strategjinë Kombëtare për të Rinjtë për një periudhë pesë vjeçare, e cila përmban edhe një Plan Veprimi për zbatim dhe i cili përgatitet nga Agjencia për Rini dhe Sport. Komunitet gjithashtu janë të detyruara të miratojnë strategji pesë vjeçare lokale për të rinjtë dhe Planet të veprimit për zbatim dhe të krijojnë këshilla lokale rinore, zyra për të rinjtë dhe qendra rinore.

Gjithashtu, organet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale janë të detyruara të caktojnë një nëpunës/e për të rinjtë, i cili/e cila do të jetë përgjegjës/e për punën e Zyrës për të rinjtë, Këshillit Rinor Lokal, si dhe për koordinimin, zbatimin dhe monitorimin e të gjitha çështjeve që janë me interes për të rinjtë në fushën e kompetencave të institucionit, përkatësisht të komunës.

Në mënyrë që të realizohen të gjitha aktivitetet e parashikuara nga LPRPR-ja, dispozitat në lidhje me financimin janë të qarta, gjegjësisht në nivelin kombëtar fondet ndahen nga Buxheti i RMV-së në vlerë prej 0.3%, ndërsa në nivelin lokal për të rinjtë ndahen fonde në shumën prej 0,1% në nivel vjetor.

Procesi i miratimit të Ligjit për Pjesëmarrjen e të Rinjve dhe Politikat Rinore filloi në vitin 2018, si një iniciativë e Klubit për Çështje dhe Politika Rinore<sup>4</sup> në Kuvendin e RMV-së (mandati 2016 - 2020)<sup>5</sup> koordinatore e së cilës ishte deputetja Ivana Tufekxhiç. Vullneti dhe konsensusi politik për këtë çështje u shprehën qartë nga të gjitha partitë politike dhe zyrtarët e lartë në Kuvend. Për qëllime të inkluzivitetit dhe gjithëpërfshirjes së procesit për miratimin e LPRPR-së, gjegjësisht përfshirjes së aktorëve (më) të prekur, u formua një Grup punues trepalësh i përbërë nga deputetë, zyrtarë të qeverisë dhe përfaqësues të formave të organizimit të të rinjve. I gjithë procesi i hartimit të LPRPR-së, i cili u zhvillua në një mënyrë jashtëzakonisht transparente dhe gjithëpërfshirëse, me përfshirjen aktive të të gjithë palëve të interesuara, u mbështet nga Misioni i OSBE-së në Shkup, e në takimet e punës mori pjesë edhe NDI, si mbështetës i punës së Klubit.

Gjatë periudhës dy-vjeçare të përgatitjes për LPRPR-së, u mbajtën më shumë se 20 takime të Grupit të punës, ndërsa takime rajonale<sup>6</sup> me të rinj u organizuan për të dëgjuar zërin dhe mendimin e tyre, ku morën pjesë më shumë se 185 të rinj dhe 123 të reja, ose më shumë se 300 të rinj. Në mënyrë që të rinjtë me aftësi të kufizuara të njiheshin me përmbajtjen e LPRPR-së, u përgatit edhe një version audio i ligjit, mbështetur nga Misioni i OSBE-së në Shkup.

4 Puna e Klubit mbështetet nga NDI

5 Anëtarë të Klubit për Çështje dhe Politika Rinore ishin deputetët dhe deputetet: Ivana Tufekxhiç, Meri L Lazarova, Agim Shaqiri, Kostadin Kostadinov, Nevena Stamenkovska, Sllajjana Mitovska, Betianie Kitev, Nola Ismailloska-Starova dhe Teuta Bilalli

6 Gjatë vitit 2018 dhe 2019, u organizuan takime në qytetet vijuese: Kumanovë, Krushevë, Prilep, Manastir, Kërçovë, Ohër, Shkup, Strumicë, Shtip, Kavadar, Tetovë dhe Strugë





Në kuadër të Agjencisë për Rini dhe Sport<sup>8</sup> ekziston një sektor i veçantë për të rinjtë. Sektori për Rini kryen aktivitete në lidhje me sferat e interesit dhe nevojat të popullatës së re në vend dhe njihjen e rolit të të rinjve në zhvillimin e RMV-së. Agjencia për Rini dhe Sport e zbaton Strategjinë Kombëtare për të Rinjtë (2016 - 2025).

Sektori për të Rinjtë i kryen obligimet, përgjegjësitë dhe detyrat e tij në dy njësi:

- **Njësia për Politikë Rinore dhe Trajtime:**

- monitoron, studion dhe shtjellon çështje që lidhen me zhvillimin psiko-fizik të të rinjve dhe propozon masa për avancimin e tyre;
  - merr pjesë në përgatitjen e Strategjisë Kombëtare për të Rinjtë të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
  - i monitoron kushtet që kanë të bëjnë me statusin shoqëror të të rinjve dhe organizimin në forma të ndryshme të bashkimit dhe propozon masa për avancimin e tyre;
  - monitoron, studion dhe shtjellon çështje që lidhen me parandalimin dhe luftën kundër sëmundjeve të varësisë, prostitucionit, krimit dhe fenomeneve të tjera sociopatologjike dhe propozon masa për t'i kapërcyer ato;
  - monitoron dhe studion çështje që lidhen me standardin e të rinjve, veçanërisht të nxënësve dhe propozon masa për avancimin e tyre;
  - i monitoron dhe i shtjellon çështjet që lidhen me papunësinë e të rinjve dhe propozon masa për t'i kapërcyer ato;
  - propozon dhe përgatit standarde dhe kritere për financimin e programeve që i inkurajojnë dhe i ndihmojnë aktivitetet e të rinjve dhe të shoqatave të tyre dhe e monitoron zbatimin e tyre;
  - përgatit analiza, elaborate, vlerësime, informacione, raporte dhe materiale të tjera dhe mbledh raporte etj.
- **Njësia për Eurointegritë dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar të të Rinjtë:**
  - propozon, planifikon dhe inkurajon bashkëpunimin ndërkombëtar të të rinjve;
  - i monitoron aktivitetet e Këshillit të Evropës në lidhje me çështjet e të rinjve dhe merr pjesë aktive në organet ku është e përfshirë Republika e Maqedonisë së Veriut;
  - merr pjesë në përgatitjen e Strategjisë Kombëtare për të Rinjtë të Republikës së Maqedonisë së Veriut;




**A keni njohuri për Kartën Rinore Evropiane?**

Karta Rinore Evropiane është një kartë zbritje dhe përfitimi për të rinjtë e moshës 15 deri në 29 vjeç, të kategorive të ndryshme. Karta u jep të rinjve mundësinë të udhëtojnë, të takojnë njerëz të rinj dhe të bëjnë miq të rinj në të gjithë Evropën. Karta Rinore Evropiane është një projekt i Agjencisë për Rini dhe Sport.

**Më shumë informacione në <http://mladinskakarticka.mk>**

8 <http://www.ams.gov.mk/za-agencijata/sektorj/sektor-mladi> (qasur në nëntor të vitit 2020)





për marrjen e masave për arritjen e barazisë gjinore nga ana e komunave. Prandaj, mundësia që komunat dhe këshillat rinore lokale, si organe të tyre, për të vendosur masa për arritjen e barazisë gjinore në komunën e tyre. Për më tepër, ligji parashikon koordinatore/e për barazinë gjinore në të gjitha institucionet shtetërore dhe komunat. Këta koordinatore/e në komuna janë tashmë një sistem i vendosur dhe pjesë e sistematizimit të njësive të vetëqeverisjes lokale<sup>11</sup>. Dokumenti i dytë i rëndësishëm është Strategjia për Barazinë Gjinore (2013 - 2020)<sup>12</sup> i cili ofron udhëzime për aktivitetet dhe masat për arritjen e barazisë gjinore në vendin tonë, dhe ku janë të përfshira edhe njësitë e vetëqeverisjes lokale.

Këto dokumente janë të rëndësishme për anëtarët e këshillave rinore lokale dhe për punonjësit e administratës komunale, sepse mbi të gjitha ato ofrojnë kornizën ligjore dhe bazën se si të jesh proaktiv dhe si të tregosh proaktivitet në vendosjen e barazisë gjinore përmes punës së përditshme.

## 1.4 Përfshirja e pjesëmarrjes së të rinjve

Një nga parimet themelore të Strategjisë Kombëtare për të Rinjtë (2016 - 2025) është përfshirja sociale ose inkluzioni social.

Për të kuptuar saktësisht se çfarë do të thotë termi përfshirje e të rinjve në proceset shoqërore, para së gjithash duhet të dihet se çfarë është barazia dhe çfarë është diskriminimi. Sipas legjislationit vendas, e po ashtu edhe sipas akteve juridike ndërkombëtare në Republikën e Maqedonisë së Veriut, vlen parimi i barazisë, sipas të cilit diskriminimi është i ndaluar:

"Barazia është një parim sipas të cilit të gjithë njerëzit janë të barabartë, gjegjësisht të barabartë në gëzimin dhe ushtrimin e të gjitha të drejtave dhe lirive."<sup>13</sup>

Një person ose një grup personash, burra dhe/ose gra, diskriminohen kur për shkak të një karakteristike të veçantë që e posedojnë, u kufizohet një e drejtë ose liri e caktuar, dhe e cila është e garantuar ligjërisht për të gjithë qytetarët dhe qytetaret. Diskriminimi rezulton në atë që ai person ose grup nuk është në gjendje t'i gëzojë ose t'i ushtrojë të gjitha të drejtat dhe liritë në mënyrë të barabartë si të gjithë të tjerët.

Karakteristikat e veçanta që janë shkak i diskriminimit dhe quhen "baza diskriminuuese" janë: raca, ngjyra e lëkurës, origjina, përkatësia kombëtare ose etnike, seksi, gjinia, orientimi seksual, identiteti gjinor, përkatësia në grup të marginalizuar, gjuha, shtetësia, prejardhja sociale, arsimi,

11 Listën e koordinatoreve/eve, si dhe e zëvendës-koordinatoreve/eve në NJVL mund ta gjeni këtu [https://www.mtsp.gov.mk/content/xslx/%D0%95%D0%B4%D0%BD%D0%B0%D0%BA%D0%B2%D0%B8%20%D0%BC%D0%BE%D0%B6%D0%BD%D0%BE%D1%B1%D1%B2%D0%BB/ELS%20koordinatori%20%20komi-sii%20mail%20adres%20tel.br%20\(3\).xls](https://www.mtsp.gov.mk/content/xslx/%D0%95%D0%B4%D0%BD%D0%B0%D0%BA%D0%B2%D0%B8%20%D0%BC%D0%BE%D0%B6%D0%BD%D0%BE%D1%B1%D1%B2%D0%BB/ELS%20koordinatori%20%20komi-sii%20mail%20adres%20tel.br%20(3).xls)

12 Strategjia e Barazisë Gjinore (2013 - 2020) në dispozicion në <http://morm.gov.mk/wp-content/uploads/2018/03/Strategjia-2013-2020.pdf> (qasur në nëntor të vitit 2020)

13 Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, neni 4 ("Gazeta Zyrtare e RMV", nr. 258/2020)





Sipas doracakut "FJALËN E KE TI! - Doracak për Kartën e Rishikuar Evropiane për Pjesëmarrjen e të Rinjve në Jetën Lokale dhe Rajonale" të zhvilluar nga Këshilli i Evropës, pjesëmarrja e të rinjve mund të sjellë përfitime shumë konkrete dhe të dukshme, jo vetëm për të rinjtë, por edhe për organizatat/institucionet dhe komunitetet në të cilat ata janë të përfshirë. Në të mund të gjenden edhe përfitime shtesë, si dhe sfida për pjesëmarrjen e të rinjve, e po ashtu edhe informacione shtesë mbi pjesëmarrjen e të rinjve në nivelin lokal.

**Maqedonisht** në këtë link: <https://rm.coe.int/have-your-say-manual-mk/168072a38a>  
**Shqip** në këtë link: <https://rm.coe.int/have-your-say-manual-alb/168072a389>

Në Preambulën e Kartës së Rishikuar Evropiane për Pjesëmarrjen e të Rinjve në Jetën Lokale dhe Rajonale jepet përkufizimi vijues: *"Pjesëmarrja e një komuniteti në jetën demokratike nënkupton shumë më tepër se sa vetëm votimi ose kandidimi në zgjedhje, edhe pse këto janë elemente të rëndësishme të pjesëmarrjes. Pjesëmarrja dhe qytetaria aktive nënkupton të kesh të drejtë, mjete, hapësirë, mundësi dhe aty ku është e nevojshme, edhe mbështetje për të marrë pjesë, për të ndikuar në vendimmarrje, si dhe për të marrë pjesë në veprime dhe aktivitete për të kontribuar në ndërtimin e një shoqërie më të mirë."*

**Bashkimi Evropian** ka strategjinë e vet për të rinjtë, e cila paraqet një kornizë për bashkëpunimin e BE-së në aspekt të politikave rinore. Strategjia i referohet periudhës (2019 - 2027). Strategjia bazohet në tre fjalë kyçe: pjesëmarrja, lidhja dhe fuqizimi i të rinjve.<sup>16</sup>

Përveç Strategjisë për të Rinjtë të BE-së, e cila siguron një kornizë dhe plan të përgjithshëm, se në ç'drejtim duhet të zhvillohen politikat dhe programet rinore në periudhën e ardhshme, ekzistojnë edhe politika të veçanta programore. Një prej tyre është programi Erasmus+, i cili u krijua për të mbështetur arsimin, trajnimin, rininë dhe sportin në Evropë.

Programi Erasmus+ zbatohet drejtpërdrejt nga ana e Komisionit Evropian, si dhe përmes agjencive kombëtare. Agjencia Kombëtare për Programet Arsimore Evropiane dhe Mobilitet<sup>17</sup> me seli në Shkup punon në promovimin dhe zbatimin e programeve evropiane në fushën e arsimit, trajnimit, të rinjve dhe sporteve në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

**Forumi Rinor Evropian (FRE)** është unioni më i madh dhe organ përfaqësues në nivelin evropian, i përbërë nga organizatat përfaqësuese kombëtare dhe organizatat ndërkombëtare të të rinjve. Në rezolutën e tyre mbi politikën rinore (1998), ata e përcaktojnë politikën evropiane për të rinjtë si një politikë ndër-sektoriale, të integruar, që synon të rinjtë, me të rinjtë dhe që buron

<sup>16</sup> [https://europa.eu/youth/strategy\\_en](https://europa.eu/youth/strategy_en) (qasur në dhjetor të vitit 2020)  
<sup>17</sup> [www.na.org.mk](http://www.na.org.mk)

nga nevojat e të rinjve. Në vitin 2017, ata zhvilluan një publikim ku përcaktohen 8 standarde të cilësisë gjatë hartimit të politikave për të rinjtë.<sup>18</sup>

Duke i përcaktuar standardet e cilësisë, Forumi Rinor Evropian në fakt, përshkruan se cila duhet të jetë situata ideale. Kjo siguron një mekanizëm për vlerësimin e situatës reale dhe identifikimin e aspekteve specifike për të cilat duhet të punohet për të përbushur standardet. Ata mund të ndihmojnë duke kaluar një proces të vetë-vlerësimit (në faqen 54), në mënyrë që të fitohet një pasqyrë më e qartë e gjendjes së politikave rinore, por edhe për atë se çfarë ndryshimi dëshirohet të arrihet me to.

### Tetë standarde të cilësisë për politikën rinore:

**1**

Qasja ndaj politikës rinore e bazuar në të drejtat e njeriut<sup>19</sup>

**2**

Politika rinore e bazuar në prova

**3**

Politika rinore pjesëmarrëse

**4**

Politika rinore me shumë nivele

**5**

Politika rinore strategjike

**6**

Disponueshmëria e burimeve për politikën rinore

**7**

Angazhimi politik dhe llogaridhënia në politikën rinore

**8**

Politika ndërsektoriale për të rinjtë

## 1.6 Pjesëmarrja e të rinjve

Pjesëmarrja është një element thelbësor i qytetarisë aktive në një shoqëri demokratike. Pjesëmarrja e të rinjve nënkupton përfshirjen e të rinjve në procese, institucione dhe vendime që ndikojnë në jetën e tyre. Pjesëmarrja e të rinjve nuk është një qëllim në vetvete, por një mjet për të arritur ndryshime pozitive në jetën e të rinjve dhe për të ndërtuar një shoqëri më të mirë. UNICEF-i beson se **pjesëmarrja është një e drejtë njerëzore** dhe për këtë arsye Konventa për të Drejtat e Fëmijëve<sup>20</sup> e thekson të drejtën e fëmijëve për të marrë pjesë. Sipas nenit 12 të Konventës, të gjithë fëmijët duhet të jenë të lirë të shprehin pikëpamjet e tyre dhe të dëgjohej mendimi i tyre.

<sup>18</sup> A Toolkit on Quality Standards for Youth Policy; European Youth Forum

<sup>19</sup> European Youth Forum "POLICY PAPER ON YOUTH RIGHTS" 2012

<sup>20</sup> [https://www.unicef.org/northmacedonia/media/1806/file/MK\\_CRC\\_1990\\_MK.pdf](https://www.unicef.org/northmacedonia/media/1806/file/MK_CRC_1990_MK.pdf) (qasur në nëntor të vitit 2020)

Sipas Ligjit për Pjesëmarrjen e të Rinjve dhe Politikat Rinore “**është një proces që u mundëson të rinjve të marrin pjesë dhe të marrin vendime të përbashkëta për politikatat dhe programet që e formësojnë drejtpërdrejt ose indirekt jetën e të rinjve**”.

Përmes pjesëmarrjes aktive, të rinjtë kanë fuqinë të luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e tyre, si dhe në komunitetet e tyre. Pjesëmarrja u ndihmon të rinjve të mësojnë aftësi jetike jetësore, të zhvillojnë njohuri për të drejtat e njeriut dhe qytetarinë, dhe të promovojnë veprime pozitive qytetare. Për të marrë pjesë në mënyrë efektive, të rinjtë duhet të pajisen me mjetet e duhura, të tilla si informacioni, edukimi dhe qasja në të drejtat e tyre civile.

## 1.7 Politika rinore

Sipas përkufizimit të dhënë në Ligjin për Pjesëmarrjen e të Rinjve dhe Politikat Rinore, “**politika rinore është një grup masash dhe aktivitete që merren për të përmbushur nevojat e të rinjve, në mënyrë që të realizojnë potencialin e tyre të plotë**”.

Politika rinore mund të krijohet posaçërisht për të rinjtë ose në lidhje me sektorët e tjerë në kuadër të cilëve është e rëndësishme të përfshihen të rinjtë. Në të njëjtën kohë, politikatat rinore mund të hasen edhe në politikatat e sektorëve të tjerë, të cilat u referohen të rinjve (p.sh. arsimi, puna dhe politika sociale). Politika rinore mund të përfshijë masa ose programe për të gjithë të rinjtë, por mund të përfshijë gjithashtu edhe masa për grupe të veçanta të të rinjve, të tilla si të rinjtë e cenueshëm ekonomikisht ose të rinjtë që jetojnë në zonat rurale.

Përveç institucioneve publike që janë krijuesit kryesorë të politikës rinore, ka edhe shumë aktorë të tjerë që mund të përfshihen në informimin, zhvillimin dhe zbatimin e politikës rinore: këshillat rinore lokale, organizatat rinore, grupet joformale rinore, punëtorët me të rinjtë, studiuesit e të rinjve, të rinjtë, shkollat, mësimdhënësit, punëdhënësit, personeli mjekësor, punonjësit socialë, mediat etj.

Politikat lokale për të rinjtë, ndryshe nga ato kombëtare, mund të jenë më të drejtpërdrejta në adresimin e nevojave të të rinjve në një komunë të caktuar. Theksojmë se është jashtëzakonisht e rëndësishme që përfshirja e të rinjve të bëhet që nga fillimi i procesit, gjegjësisht nga inicimi, planifikimi, përgatitja, zbatimi, monitorimi i politikës rinore, si dhe në vlerësimin e politikave.

Qëllimi i politikës lokale për të rinjtë është të përmirësojë pozicionin shoqëror të të rinjve në komunitetin lokal, si dhe të përcaktojë masat që do të zbatohen nga ana e institucioneve lokale dhe komuna. Politika përcakton situatën aktuale dhe definon qëllimet dhe synimet për të përmbushur nevojat e të rinjve. Me miratimin e saj, politika rinore bëhet një bazë praktike për veprimet e ardhshme të sistemit demokratik dhe politik në lidhje me të rinjtë si një burim i pashtershëm dhe i rëndësishëm në rrjedhat shoqërore.





Nëse në Statutin e komunës tashmë ka nene që i referohen Këshillit Rinor Lokal, duhet të kontrollohet nëse ato janë në përputhje me Ligjin për Pjesëmarrjen e të Rinjve dhe Politikat Rinore. Në rast se anëtarët e mundshëm të Këshillit Rinor Lokal janë në kundërshtim me Ligjin për Pjesëmarrjen e të Rinjve dhe Politikat Rinore, ato duhet të harmonizohen me ligjin.

## 2.2 Struktura e Këshillit Rinor Lokal

Këshilli Rinor Lokal përbëhet nga anëtarët, përfaqësuesit e formave të ndryshme të organizimit të të rinjve, dhe përveç anëtarëve, ka edhe kryetar/in dhe zëvendës-kryetar/in. Numri i përgjithshëm i anëtarëve të KRL-së është i ndryshëm në çdo komunë - numri i anëtarëve është tek, nuk mund të jetë më pak se pesë persona dhe nuk kalon më shumë se një e treta e anëtarëve të Këshillit të komunës. Anëtarët e Këshillit Rinor Lokal zgjedhin nga radhët e tyre se kush do të jetë kryetar/e dhe zëvendës-kryetar/e.

Këshillat rinore lokale zgjidhen nga kuvendet lokale të të rinjve, të cilat përbëhen nga përfaqësuesit e të gjitha formave të interesuara të organizimit të të rinjve që punojnë në komunë. Kjo formë e promovon gjithëpërfshirjen dhe bazohet në vlerat demokratike dhe mënyrën e zgjedhjes së përfaqësuesve të Këshillit Rinor Lokal në komunë. Një tipar kryesor i kësaj forme është që u lejon të rinjve vetë t'i zgjedhin

përfaqësuesit e tyre, duke e bërë procesin demokratik, gjithëpërfshirës, transparent dhe llogaridhënës.

### Neni 16 i Ligjit për Pjesëmarrjen e të Rinjve dhe Politikat Rinore, kushtuar **rolit dhe formimit të këshillave rinore lokale:**

**(1)** Komunitat, komunitat në Qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit me statut parashikojnë formimin e këshillave rinore lokale.

**(2)** Këshillat rinore lokale kanë rol këshillues dhe përfaqësues në komunitat, komunitat në Qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit nga fusha e çështjeve dhe politikave rinore.

**(3)** Përfaqësuesit e Këshillit Rinor Lokal kanë të drejtë të:

- propozojnë pika në rendin e ditës së Këshillit të komunës, komunave në Qytetin e Shkupit dhe Qytetin e Shkupit që i prekin të rinjtë;
- iniciojnë çështje për të rinjtë nga fusha e punës së komunave, komunave në Qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit;
- iniciojnë, marrin pjesë dhe japin informata kthyesë mbi procesin e strategjisë lokale për të rinjtë dhe politikat e tjera;
- Paraqesin informacione në njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe Qytetin e Shkupit për çështje që lidhen me të rinjtë dhe
- kryejnë punë të tjera këshilluese dhe përfaqësuese në përputhje me këtë ligj.

**(4)** Numri i anëtarëve të këshillave rinore lokale të rinisë është tek dhe nuk kalon më shumë se një e treta e anëtarëve të Këshillit të komunës, komunave në Qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit, por nuk mund të jetë më pak se pesë persona.

**(5)** Anëtarët e këshillave rinore lokale kanë mandat prej dy vjetësh me të drejtën për t'u zgjedhur edhe një herë.



## 2.3 Hapat për formimin e një Këshilli Rinor Lokal

Secila komunë duhet t'i zbatojë këto hapa për të krijuar një Këshill Rinor Lokal që promovon përfshirjen, inkluzionin dhe pjesëmarrjen e të rinjve.

Tabela përmbledhëse i tregon hapat e formimit, e më poshtë është dhënë një shpjegim shtesë për secilin prej tyre:

**Hapat për formimin e një Këshilli Rinor Lokal (Paraqitja e hollësishme tabelare është dhënë në Shtojcën 1)**

**1**

Vendimi statutor i Këshillit të komunës për ndryshimin dhe/ose plotësimin e Statutit të komunës – Themelimi i një organi të veçantë në komunë: Këshilli Rinor Lokal.

**2**

Komuna shpall Thirrje për krijimin e Këshillit Nismëtar (KN).

**3**

Thirrje për anëtarësim në Kuvendin konstituiv Lokal të të Rinjve – Këshilli Nismëtar përmes komunës shpall Thirrje publike për anëtarësim në Kuvendin Lokal të të Rinjve.

**4**

Mbajtja e seancës konstituive të Kuvendit Lokal të të Rinjve.

**5**

Thirrje për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Rinor Lokal.

**6**

Anëtarët e zgjedhur të Këshillit Rinor Lokal verifikohen nga ana e Këshillit komunal pas pranimit të vendimit për zgjedhjen e anëtarëve nga ana e Kuvendit Lokal të të Rinjve.

**7**

Pas verifikimit, në mbledhjen e parë të Këshillit Rinor Lokal zgjidhet kryetari/ ja dhe zëvendës-kryetari/ ja i/ e Këshillit dhe së bashku me anëtarët miratohet Rregullorja e punës.

### 1. Vendimi statutor i Këshillit të komunës për ndryshimin dhe/ose plotësimin e Statutit të komunës - Themelimi i një organi të veçantë në komunë: Këshilli Rinor Lokal


Si hap i parë në krijimin e Këshillit Rinor Lokal, është e nevojshme të bëhen ndryshime dhe/ose plotësime në Statutin e komunës me një vendim për krijimin e Këshillit Rinor Lokal. Vendimi duhet të votohet nga ana e Këshillit komunal dhe ai bazohet në nenin 21 dhe nenin 36 paragrafi 1, pika 1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr.







të ketë një procesverbal të shkruar nga puna e KRL-së. *Një shembull i Rregullores së punës së KRL-së është dhënë në Shtojcën 5 të këtij doracak.*



\* Vërejtje: Këto janë hapat në rast se KRL-ja formohet për herë të parë. Në një fazë të mëvonshme, me skadimin e mandatit/ëve të KRL edhe me nevojën për një përbërje të re, nuk formohet KN, por Kuvendi Lokal i të Rinjve shpall drejtpërdrejt thirrje për anëtarë.





**Nëse Këshilli Rinor Lokal ka një mandat aktiv**, gjegjësisht mandati për përfaqësimin e të rinjve në komunë i anëtarëve të zgjedhur nuk ka skaduar ende, së pari duhet të përcaktohet se sa kohë ka mbetur. Nëse koha e mbetur e mandatit është për një periudhë të shkurtër kohore, atëherë deri në mbarimin e afateve për transformim në modelin KRL të përcaktuar nga LPRPR-ja, ka të ngjarë që mandati i KRL-së të skadojë dhe është e natyrshme të formohet një KRL i ri. Në këtë rast, duhet të organizohet koha e mbetur për punë e KRL-së drejt transformimit dhe të zhvillohet modeli, të rishikohen dhe të harmonizohen aktet nënligjore dhe dokumentet që e rregullojnë funksionimin e KRL-së sipas LPRPR-së.

**Nëse anëtarët e Këshillit Rinor Lokal janë aktivë**, gjegjësisht, janë aktivë në kuadër të mandateve të tyre, rekomandohet që të përfshihen në planifikimin e këtij transformimi. Në mënyrë që të mos shuhet aktiviteti dhe entuziazmi i të rinjve rreth KRL-së, komuna duhet t'i përfshijë ata në transformimin e Këshillit Rinor Lokal. Në të njëjtën kohë, kjo mund të motivojë disa nga anëtarët e mëparshëm të kandidojnë përsëri dhe të marrin pjesë edhe në punën e Këshillit të transformuar, gjë që do ta forconte qëndrueshmërinë dhe kujtesën institucionale.

Nëse anëtarët e Këshillit Rinor Lokal nuk janë aktivë, gjegjësisht, pavarësisht nga mandati aktiv ata nuk i përbushin detyrat e tyre, nuk marrin pjesë në komunikime ose takime, do të jetë më e vështirë të përfshihen në transformimin e KRL-së. Në këtë rast, komuna mund t'i informojë ata rreth procesit që do të zhvillohet dhe rreth transformimit dhe t'u ofrojë atyre që të përfshihen në proces.

Në të dyja rastet, anëtarët e deritanishëm të KRL-së dhe personi i ngarkuar me mbështetjen e punës së tij, janë të detyruar të bëjnë një pranim-dorëzim dhe t'i mbyllin me përgjegjësi materialet nga puna e mëparshme e KRL-së. Kjo do të thotë që duhet të kontrollohet siç duhet nëse janë në dispozicion dhe nëse janë arkivuar procesverbalet e të gjitha takimeve të deritanishme, materialet dhe dokumentet e tjera në lidhje me punën e KRL-së, dhe të përgatiten raportet vjetore për prezantim dhe miratim nga Këshilli komunal. Pavarësisht nga skadimi i mandatit, anëtarët e KRL-së dhe personi përgjegjës për mbështetjen e punës së tij kanë detyrim të sigurojnë që puna e KRL-së do të dokumentohet dhe se do të përbushen detyrimet ndaj komunës dhe qytetarëve.

**Nëse KRL-ja ekzistuese është rregulluar në aktet nënligjore të komunës**, ato duhet të identifikohen, të kontrollohen se a janë në pajtueshmëri me dispozitat e LPRPR-së dhe të harmonizohen.

Përplasjet e mundshme dhe të pritshme, nëse KRL-ja është rregulluar në Statutin e komunës, janë:

- Komuna të parashohë KRL me një numër të ndryshëm të anëtarëve nga ai që parashihet në LPRPR (shumë këshilla kanë 7 anëtarë. LPRPR-ja parashikon që numri i anëtarëve të jetë tek, të mos kalojë më shumë se një të tretën e numrit të anëtarëve të Këshillit të komunës dhe të mos numërojë më pak se 5 persona).
- Këshilli Rinor Lokal të ketë një mandat të anëtarëve të ndryshëm nga ai në LPRPR-së (shumë KRL në të kaluarën kishin një mandat prej 4 vjetësh, gjë që e bënte të vështirë



## 2.5 Formimi i ekipit dhe konsultimi

Procesi i transformimit i Këshillit Rinor Lokal duhet të jetë i menduar mirë dhe duhet të konsultohen palët kryesore të interesit disa herë. Për transformimin, komuna duhet të përcaktojë një person të përgjegjshëm që do ta udhëheqë këtë proces - në mënyrë ideale ai/ajo do të ishte personi që ka punuar deri tani në çështjet e rinisë dhe/ose nëpunësi/ja për të rinjtë. Nëse ky person nuk është personi i njëjtë që ka qenë përgjegjës për KRL-në aktuale dhe/ose nëpunësi/ja për të rinjtë, duhet të konsultohet me ta dhe të bashkëpunojnë. Për të gjitha ndryshimet kryesore, personi përgjegjës duhet të konsultohet me nëpunësin/en për të rinjtë dhe shërbimet për çështje juridike, si dhe të informojë personat përgjegjës dhe kryetarin/en e komunës.

Personi përgjegjës është gjithashtu përgjegjës për konsultime me të rinjtë që kanë qenë ose janë anëtarë të Këshillit Rinor Lokal. Nëse anëtarët janë aktivë, ata duhet të informohen dhe të marrin pjesë në planifikimin e transformimit, e nëse jo, duhet të njoftohen për këtë.

Rekomandohet që personi përgjegjës dhe komuna të bashkëpunojnë me organizatat rinore lokale në mjedisin e tyre dhe të mbledhin informacion mbi zbatimin e LPRPR-së, mbi përshtypjet nga puna e Këshillit deri atëherë dhe mbi transformimin.

Është e mundur që në këtë proces të lindin pyetje dhe nevojë për sqarim të qëllimeve të LPRPR-së dhe të modeleve të punës së Këshillit. Personi përgjegjës nga komuna duhet ta kontaktojë Agjencinë për Rinë dhe Sport, gjegjësisht Sektorin për të Rinjtë, për të kërkuar udhëzime, shpjegime dhe rekomandime shtesë në këtë proces.

Ndryshimet dhe harmonizimi nuk janë të nevojshme vetëm për të harmonizuar punën e komunës me ligjet, por janë të lidhura ngushtë me suksesin e Këshillit Rinor Lokal. Gjatë viteve nuk ka pasur një formë të vetme të Këshillit Rinor, dhe secila komunë ka formuar organe të ndryshme. Përmes këtyre përvojave të ndryshme, monitorimit dhe hulumtimit të tyre, do të krijohen konkluzione ose rekomandime shtesë në bazë të mësimave të nxjerra në lidhje me modelin ideal të kërkuar të KRL-së që do të kontribuojë në procesin e hartimit të politikave, do të sigurojë pjesëmarrjen e të rinjve dhe do të jetë i qëndrueshëm.



# PËRFITIMET NGA KËSHILLAT RINORE LOKALE

## Përfitimet për komunën

Me krijimin dhe përfshirjen e Këshillit Rinor Lokal, komuna tregon hapjen dhe gatishmërinë për të marrë pjesë në krijimin e politikave rinore. Këshilli Rinor Lokal, përmes rolit të tij këshillues, e njofton komunën me nevojat, sfidat dhe problemet me të cilat përballen të rinjtë në komunitetin lokal dhe jep rekomandime për zgjidhjen e tyre. Këshilli Rinor Lokal mundet ta ndihmojë komunën që t'i planifikojë politikat e saj duke marrë parasysh interesat dhe nevojat e të rinjve, e me këtë t'i përmirësojë mundësitë dhe të ardhmen e tyre në komunën e tyre. Këshilli Rinor Lokal për një komunë do të thotë gjithashtu një mundësi për kreativitet në qasjet e saj. Mënyra më e mirë për komunën që të krijojë dhe të zbatojë politika të mira për të rinjtë është t'i përfshijë ata në krijimin e tyre, t'i pyesë për nevojat dhe rekomandimet e tyre në mënyrë që të dëgjohet mendimi i tyre.

## Përfitimet për të rinjtë

Me krijimin e Këshillit Rinor Lokal në komunë, të rinjtë fitojnë një kanal të garantuar për komunikim me autoritetet lokale. Përmes KRL-së ata mund t'ia ofrojnë komunës idetë e tyre novatore dhe propozimet kreative dhe ta inkurajojnë që t'i zbatojë ato. Ata gjithashtu mund të konsultohen me njëri-tjetrin, t'u jepet mundësia ta thonë fjalën e tyre, të ndërtojnë pikëpamje të përbashkëta dhe t'i përfaqësojnë ato përpara komunës. Ky mjet për pjesëmarrje, të rinjve u ofron mundësi të jenë iniciatorë dhe pjesëmarrës në proceset e hartimit të politikave për të rinjtë dhe të kenë një kontribut të drejtpërdrejtë në përmirësimin e jetës së tyre në mjedisin ku ata jetojnë.









## 3.1 Kompetencat e komunave që dalin nga Ligji për Pjesëmarrjen e të Rinjve dhe Politikat Rinore

Komunat janë institucionet kryesore me kompetencë për të krijuar këshilla rinore lokale dhe për të zbatuar Ligjin për Pjesëmarrjen e të Rinjve dhe Politikat Rinore. Përmes përgatitjes së mirë, duke ndjekur dispozitat ligjore dhe përvojat e kaluara në këtë fushë, komunat kanë kapacitetin për të krijuar këshilla të qëndrueshëm dhe funksional rinorë që do të kontribuojnë në punën dhe hapjen më të mirë të komunës. Kujdesi për t'i ndjekur këto hapa do të bëjë dhe do të mundësojë që komuna të fitojë një KRL funksional dhe të dobishëm që do të përmirësojë punën e saj.



*Nëse krijimi i Këshillit është i nxituar, pa pjesëmarrje të konsiderueshme të të rinjve ose pa siguruar komunikim me vendimmarrësit në komunë, atëherë ekziston rreziku që ai të jetë një organ pasiv për të cilin anëtarët (të rinjtë) mund ta humbin interesin dhe puna e tij të shuhet dhe përpjekjet e bëra të jenë të pasuksesshme.*

Për të mbështetur krijimin e KRL-ve, duke i ndjekur udhëzimet e LPRPR-së dhe duke u mbështetur në përvojën e deritanishme, më poshtë janë dhënë shpjegime dhe rekomandime për hapat që komunat duhet t'i ndërmarrin për të kontribuar në suksesin e këtij procesi.

### 3.1.1 Nëpunësi/ja për të rinjtë


Përvojat tregojnë se komunat që kanë emëruar më parë një person përgjegjës, përkatësisht koordinator/e për bashkëpunim dhe mbështetje të punës së të rinjve dhe KRL-së, nga radhët e administratës komunale, kanë më shumë sukses në politikat rinore. Në të njëjtën kohë, ky person është lidhja kryesore për bashkëpunimin e suksesshëm midis KRL-së dhe komunës. Me LPRPR parashihet "nëpunësi/ja për të rinjtë", të cilin duhet ta ketë çdo komunë. Funkzioni i nëpunësit/es për të rinjtë është të jetë përgjegjës/e për punën e Këshillit Rinor Lokal, për Zyrën për të Rinjtë, si dhe për koordinimin dhe monitorimin e çështjeve për të rinjtë në kuadër të fushëveprimit të punës së institucionit. Nëpunësi/ja për të rinjtë është personi përgjegjës për krijimin dhe funksionimin e KRL-së, dhe kontakti midis institucionit dhe Këshillit, si dhe kontakti me sektorin civil të të rinjve.

Nëpunësi/ja për të rinjtë është përgjegjës/e për inkurajimin dhe mbështetjen e punës së Këshillit, për të siguruar ndihmë në caktimin dhe organizimin e mbledhjeve, takime me institucionet, për



### 3.1.2 Zyra për të rinjtë

Komuna duhet të sigurojë kushte teknike dhe hapësinore për punën e Këshillit Rinor Lokal. Nga kjo varet mundësia për punë të papenguar, mbajtje të takimeve dhe koordinim të Këshillit.



Kushtet minimale që duhet t'i sigurojë komuna janë: një zyrë ku mund të punohet dhe të mbahen takime të vogla, një tryezë pune, karrige, kompjuter, shtypës dhe qasje në internet, si dhe pajisje themelore për zyrë.


Secila komunë ka detyrim ligjor të hapë një zyrë për të rinjtë, nga e cila nëpunësi/ja për të rinjtë e koordinon punën për të rinjtë dhe e cila është pika kryesore e qasjes së të rinjve te komuna. Çdo zyrë për të rinjtë duhet të përshtatet për të siguruar funksionimin e papenguar dhe të rregullt të KRL-së. Me kërkesë të nëpunësit/es për të rinjtë dhe KRL-së, komuna duhet t'i lejojë ata të përdorin një sallë për takime në komunë.

Këto kushte do të mundësojnë nritjen e funksionalitetit të KRL-së, mundësi për punë, koordinim me nëpunësin/en për të rinjtë, mbajtjen e takimeve dhe seancave të Këshillit, takime me përfaqësuesit e institucioneve, të organizatave rinore ose në përgjithësi do të jetë një vend ku çdo i ri nga komuna do të jetë në gjendje të takohet me anëtarët e KRL-së.

### 3.1.3 Njohja me komunën dhe trajnimet për Këshillin Rinor Lokal

Duke marrë parasysh se anëtarët e KRL-ve janë të rinj, me nivel të ndryshëm të përvojës dhe të njohurive për çështjet dhe politikatat rinore dhe punën e komunës, është veçanërisht e rëndësishme të mbahet një trajnim pas themelimit të Këshillit për t'i informuar ata në lidhje me punën e KRL-së, politikatat rinore, si dhe fushëveprimin dhe kompetencat e komunës. Pas themelimit të KRL-së, rekomandohet që nëpunësi/ja për të rinjtë dhe komuna të organizojnë trajnime për ngritjen e kapaciteteve të anëtarëve të Këshillit Rinor Lokal.





Gjatë procesit të krijimit të strategjisë, komuna formon një ekip që do ta koordinojë gjithë procesin. Ekipi duhet ta identifikojë situatën aktuale të të rinjve në komunitet dhe të identifikojë nevojat e tyre kryesore, të cilat do t'i paraqesë para publikut të gjerë lokal. Përcaktimi i drejtë i nevojave të të rinjve është detyra më e rëndësishme e të gjithë atyre që punojnë me të rinjtë dhe për të rinjtë.

Marrja e vendimeve që do të jenë prioritetet e strategjisë është një hap i rëndësishëm dhe ndonjëherë i vështirë, gjatë të cilës duhet të përcaktohet se cilat probleme kanë vlerë më të lartë. Në bazë të nevojave të përcaktuara të të rinjve dhe prioriteteve të identifikuara, ekipi përgjegjës për zhvillimin e Strategjisë Lokale për të Rinjtë, përcakton qëllimet dhe masat konkrete për të përmbushur nevojat e identifikuara të të rinjve. Është e rëndësishme që prioritetet, qëllimet dhe masat e përcaktuara të jenë në përputhje me Strategjinë Kombëtare për të Rinjtë në mënyrë që të sigurohet një qasje dhe qëndrueshmëri e koordinuar.


I gjithë procesi duhet të përfshijë një konsultim publik me të gjithë aktorët lokalë që janë të interesuar për politikën rinore, të cilët do të ofrojnë perspektiva të ndryshme, shkëmbim të mendimeve dhe rekomandime për përmirësimin e qasjeve. Strategjia përfundimtare Lokale për të Rinjtë, e konsultuar me publikun, e veçanërisht me të rinjtë, miratohet nga Këshilli komunal. Komuna siguron transparencë dhe llogaridhënie për zbatimin e strategjisë, përmes përgatitjes dhe publikimit të raporteve të rregullta dhe koordinimit me Agjencinë për Rini dhe Sport.

### 3.1.5 Financimi

Për të realizuar programin e planifikuar vjetor të punës, e me këtë edhe legjitimitetin e aktiviteteve të planifikuara, Këshilli Rinor Lokal përgatit një plan financiar për realizimin e programit. Plani financiar së bashku me programin e punës së Këshillit Rinor Lokal i propozohet për miratim së pari Kuvendit Lokal të të Rinjve, dhe pas miratimit të tij nga Kuvendi, programi i dorëzohet Këshillit komunal. Në seancën për miratimin e planit financiar, anëtarët e Këshillit të komunës kanë të drejtë të kërkojnë shpjegime shtesë për kërkesa të caktuara buxhetore, ndërsa Këshilli Rinor Lokal është i detyruar të jep shpjegim të duhur për secilin shpenzim të planifikuar. Buxheti i aprovuar për punën e Këshillit Rinor Lokal është pjesë e buxhetit komunal dhe duhet të përcaktohet në një linjë të veçantë buxhetore, gjegjësisht program të veçantë, në buxhetin e komunës.

Me LPRPR-në, komunat janë të detyruara të ndajnë të paktën 0,1% të fondeve nga buxheti vjetor për zbatimin e ligjit, ndër të cilat duhet të gjenden fonde edhe për financimin e shpenzimeve për punën e Këshillit Rinor Lokal dhe për realizimin e programit vjetor të tij.





Procesverballi përmban datën e mbledhjes, anëtarët e pranishëm, rendin e ditës, vendimet e marra dhe vërejtjet nga diskutimi. Procesverbalet janë të nevojshme për të vërtetuar dhe arkivuar punën e KRL-së, dhe janë të rëndësishme për anëtarët që mungojnë për t'u informuar për vendimet, si dhe për të ruajtur kujtesën institucionale.

Parimi i publicitetit dhe i transparencës duhet të respektohet gjatë punës së seancave të KRL-së, gjegjësisht të rinjtë (publiku) duhet të kenë mundësinë të marrin pjesë gjatë seancave.

### 3.2.2 Krijimi i programit vjetor

Një nga hapat e para të punës është që të ketë një plan dhe marrëveshje se çfarë do të punohet, gjegjësisht të krijohet dhe të përgatitet një program vjetor i punës. Prandaj, pas themelimit, anëtarët e KRL-së duhet të bisedojnë dhe të përgatisin një program për punën e tyre.

Programi vjetor është një dokument që përmban të gjitha idetë, propozimet dhe planet e punës për një periudhë prej 12 muajsh që i referohet vitit aktual. Programi vjetor bazohet në nevojat reale të të rinjve në komunë dhe duhet të përmbajë plane dhe aspirata për të zgjidhur problemet dhe nevojat e të rinjve.

Programi vjetor duhet t'i përmbajë fushat dhe qëllimet prioritare të cilat i synon Këshilli dhe anëtarët e tij, të cilat janë me interes për të rinjtë dhe në kuadër të fushëveprimit të komunës. Secili qëllim i programit të punës së KRL-së lidhet me aktivitetet që do të kryhen nga Këshilli, gjegjësisht aktivitetet kryhen për të përmbushur qëllimet (Shtojca 10). Anëtarët e KRL-së, para se të finalizojnë programin, duhet të konsultohen me Kuvendin Lokal të të Rinjve dhe nëpunësin/en për të rinjtë, dhe më pas atë ia dorëzojnë Këshillit të komunës për miratim.

Duhet të merret parasysh se jo të gjitha aktivitetet, masat ose ndërhyrjet që propozohen kanë të njëjtin efekt mbi të gjithë të rinjtë në komunë. Gjatë krijimit të programit vjetor, preferohet që të bashkëpunohet me koordinatorin/en për mundësi të barabarta në komunë, si dhe me anëtarët e Komisionit për mundësi të barabarta. Për më tepër, duhet të hulumtohet dhe të përcaktohet nëse aktivitetet e propozuara nga KRL-ja janë neutrale në aspekt gjinor, ose kanë ndikim më të madh mbi njërin ose gjininë tjetër. Kjo analizë e shkurtër do të sigurojë që aktivitetet e propozuara të jenë saktësisht të orientuara për grupet e synuara dhe të kenë dimension gjinor. Përveç kësaj, zbatimi i kësaj qasje do të sigurojë vendosjen e barazisë gjinore, por edhe gjithëpërfshirje në masat e propozuara.

Këshilli Rinor Lokal ka për detyrë të përgatisë programin vjetor të punës për çdo vit. Rekomandohet që programi vjetor të përgatitet më së voni në fund të Tetorit të çdo viti, në mënyrë që të ketë kohë për ta dorëzuar dhe miratuar në një seancë të Këshillit komunal për shkak të afateve për procedurat e tilla.

Komuna gjithashtu ka një buxhet për të rinjtë, i cili mund të përdoret edhe për programin e KRL-së. Ky buxhet nuk është në pronësi të KRL-së, por ato janë burime financiare të cilat i siguron







### 3.2.5 Konsultimet me të rinjtë

Si një KRL që punon për të gjithë të rinjtë, anëtarët e KRL-së duhet gjithashtu t'i informojnë dhe të konsultohen edhe me të rinjtë që nuk janë anëtarë të organizatave. Kjo mund të bëhet përmes ngjarjeve publike ose konsultimeve. Konsultimet mund të kryhen edhe në mënyrë elektronike ose përmes anketës. Konsultimet e këtyra duhet të jenë në dispozicion për të gjithë, dhe të rinjtë duhet të jenë të lirë t'i shprehin nevojat dhe problemet e tyre.

Për nevoja më specifike, KRL-ja mund të organizojë takime si me të rinjtë ashtu edhe me vendimmarrësit duke përdorur metodën e "Dialogut strukturor",<sup>23</sup> me ç'rast për një çështje të caktuar në një vend mund të dëgjohen mendimet e të rinjve dhe të vendimmarrësve ose të përfaqësuesve të institucioneve përgjegjëse lokale ose kombëtare.

### 3.2.6 Prania në seancat e Këshillit të komunës

Funksioni kryesor i KRL-së është të jetë zëri i të rinjve gjatë krijimit të politikave dhe marrjes së vendimeve në komunë. Anëtarët e KRL-së kanë të drejtë të marrin pjesë, të propozojnë pika në rendin e ditës së Këshillit të komunës, dhe të iniciojnë çështje për të rinjtë nga fushëveprimi i punës së komunave. Pjesëmarrja në seancat e Këshillit të komunës është e detyrueshme për anëtarët e KRL-së. Ky është një nga rolet dhe mundësitë më të rëndësishme të Këshillit Rinor Lokal - të përcjellë kërkesat e të rinjve në Këshillin e komunës dhe të përpiqet t'i shndërrojë ato në politika dhe zgjidhje reale.

Seancat e këshillave të komunave janë publike, por meqenëse KRL-ja është organ i komunës, pjesëmarrja në seanca duhet të organizohet në koordinim me nëpunësin/en për të rinjtë. Komuna ose administrata komunale e ngarkuar me përgatitjen e seancave të Këshillit të komunës është e detyruar të dorëzojë një kopje të materialit për seancën e Këshillit komunal në KRL, në përputhje me mënyrën e dorëzimit deri te anëtarët e Këshillit komunal. Edhe nëse nuk ka pika në lidhje me të rinjtë në seancat e Këshillit komunal, mund të caktohet një anëtar/e që do të marrë pjesë, në mënyrë që të ndjekë rrjedhën e debatit (si dhe në rast se diskutohen çështje që i prekin të rinjtë).

Anëtarët e KRL-së, në koordinim me nëpunësin/en për të rinjtë mund të iniciojnë edhe vetë që ndonjë çështje e caktuar për të rinjtë të vendoset në rendin e ditës së seancës së Këshillit komunal.

<sup>23</sup> "Dialogu strukturor nga A në Z" i disponueshëm në maqedonisht në: <http://www.nms.org.mk/wp-content/uploads/2020/06/Strukturen-djalog-od-A-do-Sh.pdf> (qasur në dhjetor të vitit 2020)



- Përfaqësimit të nevojave të këtyre të rinjve para komunave, përkatësisht përfaqësimi i tyre para krijuesve të politikave;
- Propozimi i zgjidhjeve, ndikimi dhe pjesëmarrja në vendimmarrje që ndikojnë në jetën e këtyre të rinjve.

Në mënyrë që të shpjegohet më konkretisht se çfarë do të thotë e gjithë ajo që u përmend më lart, në vazhdim është dhënë një shembull i pjesëmarrjes së të rinjve me aftësi të kufizuara në jetën politike dhe shoqërore.

Megjithëse në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk ka një regjistër të saktë të personave me aftësi të kufizuara, prapëseprapë ka të rinj që në vendin tonë kanë një lloj aftësie të kufizuar. Organizatat rinore, organizatat për të rinjtë dhe të gjitha format e tjera të organizimit të rinisë, duke përfshirë edhe KRL-në, duhet të sigurojnë kushte për pjesëmarrje politike dhe aktivizim të këtyre të rinjve, pavarësisht nga lloji i aftësisë së tyre të kufizuar. Në mënyrë që një person i ri me aftësi të kufizuara fizike/trupore të jetë në gjendje të marrë pjesë aktivisht në punën e KRL-së, hapësirat që i përdor KRL-ja duhet të jenë të qasshme për ta. Nëse nuk ka platformë adekuate për hyrje, ashensor, tualet të përshtatur, etj., këta persona do të përjashtohen automatikisht nga pjesëmarrja në punën e KRL-së, pavarësisht nga ajo se e kanë atë të drejtë. Nëse materialet, programet dhe dokumentet nuk janë në dispozicion dhe nuk janë në formate që janë të kuptueshme për njerëzit me aftësi të kufizuara shqisore (me dëgjim, shikim të dëmtuar, etj.), ata gjithashtu do të përjashtohen automatikisht dhe nuk do të jenë në gjendje të japin kontributin e tyre në punën e KRL-së. Përjashtimi i tyre, nga ana tjetër, përfshin pamundësinë për t'i perceptuar dhe kuptuar problemet dhe vështirësitë me të cilat përballen këta të rinj dhe me vetë këtë, pamundësinë për të propozuar zgjidhje adekuate për të përmirësuar cilësinë e jetës.



### 3.2.9 Raporti vjetor

Në mënyrë që të jetë në gjendje të punojë me përgjegjësi dhe të japë llogari, KRL-ja duhet t'i informojë anëtarët e Kuvendit të tij Lokal të të Rinjve, komunën dhe të rinjtë në komunë. KRL-ja është e detyruar të përgatisë raporte vjetore për punën e saj, të cilat ia dorëzon Kuvendit të saj, Këshillit komunal dhe pas miratimit të tyre, i publikon ato. Gjatë përgatitjes së raporteve, anëtarët e KRL-së mund të kërkojnë ndihmë nga nëpunësi/ja për të rinjtë.

Raporti duhet të informojë se çfarë dhe si ka punuar KRL-ja vitin e kaluar, për çfarë ka mbajtur takime dhe sa takime gjithsej, për cilat çështje ka diskutuar dhe cilat vendime i ka marrë. Është e rëndësishme të informojë se për cilat çështje për të rinjtë ka avokuar KRL-ja gjatë vitit të kaluar, në çfarë mënyre (takime me institucionet, dorëzimi i propozimeve të politikave dhe cilat ishin arritjet. Nëse ka pasur ndryshime në politikat rinore (p.sh. është pranuar një kërkesë për ndriçim më të mirë në vendet publike, një shteg i ri biçikletash ose transport më i shpeshtë deri te shkollat), kjo duhet të theksohet si një sukses ose si një ndryshim pozitiv.

Pas përgatitjes së raportit, duhet të organizohet një prezantim përpara Kuvendin Lokal të të Rinjve. Pasi raporti të mbyllet nga KRL-ja, ai dorëzohet dhe prezantohet në Këshillin e komunës. Raporti vjetor i miratuar publikohet në version elektronik në ueb-faqen e komunës.

### 3.2.10 Përfundimi i mandatit dhe procesi i pranim-dorëzimit nga anëtarësia e vjetër tek anëtarësia e re

Pas përfundimit të mandatit të KRL-së dhe zgjedhjes së anëtarësisë së re, duhet të bëhet pranim-dorëzimi i punës. Ky proces është jashtëzakonisht i rëndësishëm për anëtarësinë e vjetër dhe atë të re, sepse në atë mënyrë do të sigurohet funksionaliteti i KRL-së dhe kujtesa institucionale.

Pranim-dorëzimi i punës duhet të bëhet menjëherë pas zgjedhjes së anëtarësisë së re. Ky proces përfshin një takim midis anëtarëve të vjetër dhe anëtarëve të rinj, si dhe dorëzimin e dokumenteve<sup>24</sup> të përgatitura nga KRL-ja, materialet e zyrës dhe materialet teknike dhe/ose pajisjet me të cilat disponon KRL-ja, si dhe çdo informacion të dobishëm për punën e KRL-së gjatë mandatit të saj. Është e dëshirueshme që në këtë proces të përfshihet edhe nëpunësi/ja për të rinjtë, si dhe të bëhet një procesverbal formal për materialet dhe dokumentet e dorëzuara.

24 Dokumentet e zakonshme që do të dorëzohen janë: Rregulloret e punës së KRL-së, programet vjetore, lista e aktiviteteve të implementuara, procesverbalet, raportet, lista e kontakteve të anëtarëve të KRL-së, lista e kontakteve të aktorëve relevantë (organizatat për të rinjtë, organizatat rinore, organizatat kombëtare ombrellë, vullnetarët, punëtorët me të rinjtë, përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare)



KRL-ja ka ndikuar që komuna t'i ndryshojë qasjet ekzistuese ose të krijojë qasje të reja për të rinjtë në komunë	
KRL-ja konsultohet me të rinjtë në komunë dhe i inkurajon ata që t'i drejtohen KRL-së, dhe i përcjell mendimet dhe nevojat e tyre në komunë	
KRL-ja kërkon përgjegjësi dhe e vlerëson efektivitetin e udhëheqësve të KRL-së, aktivitetin e tyre dhe përkushtimin ndaj pozicionit që e kanë	
KRL-ja merr vendime në mënyrë të pavarur dhe nuk ndikohet nga komuna ose strukturat e tjera të jashtme	

Kur bëni vetëvlerësim, është e rëndësishme që secila përgjigje të mbështetet me shembuj konkretë, në mënyrë që procesi të jetë i justifikuar dhe legjitim. Vetëvlerësimi duhet të kryhet rregullisht, duke i përfshirë palët e ndryshme të interesit që janë pjesë e Këshillit Rinor Lokal.

### 3.3 Transparenca në punën e Këshillit Rinor Lokal

Të jesh anëtar i KRL-së në një komunë është nder, por edhe përgjegjësi ndaj të rinjve në komunë. Vetë pozicioni i anëtarit nuk do të thotë të fitohet autoritet dhe mbështetje nga të gjithë të rinjtë, por përkundrazi, anëtarësia në KRL duhet të dëshmohet duke treguar se për çfarë angazhohet dhe si bëhet kjo për të rinjtë. Në mënyrë që të fitohet besimi, mbështetja dhe autoriteti, anëtarët e KRL-së duhet të jenë në komunikim të vazhdueshëm me të gjithë aktorët me ndikim - si të rinjtë ashtu edhe institucionet. Kjo do të thotë se është e nevojshme të promovohet roli i KRL-së në mesin e të rinjve, por edhe para institucioneve lokale.

Puna e KRL-së duhet të jetë e dukshme për publikun dhe çdo të ri të interesuar, veçanërisht sepse KRL-ja është një organ publik dhe përfaqësues, që i përfaqëson interesat e të gjithëve. Kështu që, është e rëndësishme që KRL-ja të jetë transparente dhe llogaridhënëse ndaj publikut dhe të rinjve në komunë, ku marrëdhëniet me publikun kanë një rol të veçantë.


Disa nga informacionet më të rëndësishme për publikun në lidhje me Këshillin Rinor Lokal janë:

- Cila është puna e KRL-së? Cilat janë arritjet e tij të fundit dhe në çfarë përqendrohet ai në punën e tij për të rinjtë?
- Kush e përbën atë, kush janë anëtarët dhe cilat janë rolet e tyre?
- Cila është kohëzgjatja e mandatit të Këshillit Rinor Lokal?
- A ka Këshilli program, buxhet dhe raporte, dhe ku mund të gjenden ato?
- Në çfarë mënyre dhe përmes cilave kanale mund të kontaktohet KRL-ja?

Përgjigjet për të gjitha këto pyetje duhet të jenë lehtë të arritshme, dhe më poshtë janë disa udhëzime se si mund të bëhet kjo.





- 
- 3. Informimi:** Mirëmbajtja e rregullt, gjegjësisht azhurnimi i ueb-faqes së Këshillit Rinor Lokal dhe i faqeve në Facebook/Instagram, dërgimi i buletineve mujorë;
  - 4. Kontaktimi:** Listat me e-maile, grupet në Facebook, Zoom, Messenger, Viber, WhatsApp janë mjete që mund të përdoren për të komunikuar me të rinjtë.

### 3.3.3 Ngjarjet publike

Këshilli Rinor Lokal i komunës mund të organizojë lloje të ndryshme të ngjarjeve publike për nevojat e të rinjve dhe për nevojat e vetë Këshillit Rinor Lokal, siç janë: debate dhe diskutime publike; takime konsultative; tryeze të rrumbullakëta; aksione të përbashkëta dhe konsultime të tjera me të rinjtë.

Para fillimit të organizimit të një ngjarjeje, duhet të përcaktohet cili është qëllimi - nëse përmes asaj ngjarje qëllimi është të dëgjohen mendimet e të rinjve, të konsultohen për qëndrimet apo të prezantohet puna e KRL-së. Ngjarjet duhet të organizohen në bashkëpunim me komunën. Ata duhet - të informohen për ngjarjet, të ofrojnë hapësirë, të kenë pjesëmarrësin e tyre ose të japin rekomandimet e tyre për mbajtjen e ngjarjes. Ngjarjet mund të organizohen edhe nga aktorë të tjerë të interesuar (si për shembull nga komuna, organizatat rinore, shkollat, etj.), ndërsa KRL-ja të ketë përfaqësuesin e vet. Në ato raste, përfaqësuesi i KRL-së duhet të koordinohet me anëtarët e KRL-së dhe komunën në lidhje me pjesëmarrjen.

### 3.3.4 Mediat sociale dhe mjetet e komunikimit në internet

Prania në internet (online) e KRL-së është veçanërisht e rëndësishme sepse aty gjendet audiencia kryesore që i prek të rinjtë. Nuk është e rëndësishme vetëm që KRL-ja të ketë prani në internet, por gjithashtu të informojë rregullisht për aktivitetet e tij dhe të mbajë komunikim të rregullt me të rinjtë. Secili Këshill Rinor Lokal duhet të ketë të dhëna në ueb-faqen e komunës.

#### - Nën-faqe për KRL-në në kuadër të ueb-faqes së komunës

Në ueb-faqen e njësisë së vetëqeverisjes lokale duhet të krijohet një seksion ose nën-faqe për KRL-në, në mënyrë që çdokush të ketë mundësi qasjeje dhe të marrë informacion në mënyrë të organizuar. Atje duhet të jenë në dispozicion të dhënat e mëposhtme:

- Informacioni i kontaktit për KRL-në (numri i telefonit, adresa dhe e-maili);
- informacion mbi përbërjen dhe anëtarët e KRL-së, adresat e tyre të e-mailit dhe numrat e telefonit;
- raportet mbi punën e KRL-së për vitet e fundit, dokumente të rëndësishme të Këshillit (Rregullorja e punës, Programi i punës).

#### - Faqja në Facebook

Facebook-u është një element i rëndësishëm i pranisë në internet kur bëhet fjalë për komunikimin e sotëm me të rinjtë dhe publikun. Nëse KRL-ja vendos të ketë faqen e vet zyrtare në Facebook, ajo duhet ta informojë komunën për këtë. Faqja duhet të mirëmbahet rregullisht me njoftime për














Mbledhja e parë e Kuvendit Lokal të të Rinjve (menjherë pas mbledhjes konstituive) thirret nga kryetari/ja tashmë i/e zgjedhur i/e Kuvendit. Në mbledhje miratohet Rregullorja e punës, e përgatitur dhe e propozuar nga komisioni dhe merret Vendim për të shpallur Thirrje publike për krijimin e Këshillit Rinor Lokal të komunës, me kriteret në përputhje me Ligjin për Pjesëmarrjen e të Rinjve dhe Politikat Rinore. Thirrja publike publikohet në ueb-faqen e komunës, në mediat lokale dhe në vende të tjera publike/ mediat sociale në mënyrë që të informohen sa më shumë të rinj në komunë. Thirrja duhet të zgjasë të paktën 10 ditë nga dita e publikimit të saj.

Pas dorëzimit të aplikimeve të kandidatëve për anëtarë të Këshillit Rinor Lokal, personi kompetent, përkatësisht nëpunësi për të rinjtë e dorëzon dokumentacionin e të gjithë aplikuesve te kryesuesi/ja i/e Kuvendit, i/e cili/a thërret një seancë të re të Kuvendit. Në mbledhjen e Kuvendit Lokal të të Rinjve ftohen delegatët e Kuvendit dhe të rinjtë që kanë aplikuar për anëtarë të Këshillit Rinor Lokal, e që i plotësojnë kriteret e thirrjes.

Komisioni i verifikimit me tre anëtarë i Kuvendit Lokal të të Rinjve (i krijuar gjatë seancës konstituive) e monitoron procesin e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Rinor të komunës dhe duhet t'i konfirmojë mandatet e delegatëve.

Kandidatët për anëtarë të Këshillit Rinor Lokal kanë të drejtë për një prezantim të shkurtër të programit të tyre para anëtarëve të Kuvendit, e më pas vijon procedura e votimit. Kuvendi Lokal i të Rinjve i zgjedh anëtarët e Këshillit Rinor Lokal përmes zgjedhjeve të drejtpërdrejta me votim të fshehtë në të cilin të drejtë vote kanë delegatët e Kuvendit Lokal të të Rinjve. Për anëtarë të zgjedhur të Këshillit Rinor Lokal konsiderohen ata anëtarë që kanë fituar më shumë vota nga delegatët e pranishëm, duke marrë parasysh përfaqësimin e ekuilibruar të të dy gjinive.

Numri i anëtarëve të Këshillit Rinor Lokal është tek dhe nuk kalon më shumë se një e treta e anëtarëve të Këshillit të komunës. Anëtarët e Këshillit Rinor Lokal kanë mandat prej dy vjetësh me të drejtën për t'u zgjedhur edhe një herë.

Kandidatët për anëtarë të Këshillit Rinor Lokal propozohen nga: organizatat e shoqërisë civile dhe shoqatat e të rinjve, këshillat e komuniteteve shkollore, këshillat e studentëve dhe format e tjera të organizatave rinore.

Në bazë të propozimeve me shkrim të propozuesve mbi propozimin e Komisionit për Çështjet e Mandatit, Zgjedhjeve dhe Emërimeve, Këshilli i komunës së XXX e zgjedh dhe e shkarkon Këshillin Rinor Lokal në bazë të vendimit të Kuvendit Lokal të të Rinjve. Këshilli Rinor Lokal nga radhët e tij zgjedh kryetar/e dhe zëvendës-kryetar/e, në përputhje me Rregulloren e punës së Këshillit Rinor Lokal.







## Shtojca 3 – Thirrje publike për krijimin e Këshillit Nismëtar

### THIRRJE PËR KRIJIMIN E KËSHILLIT NISMËTAR

Komuna shpall thirrje publike për krijimin e Këshillit Nismëtar (KN) në bazë të nenit 17 të Ligjit për Pjesëmarrjen e të Rinjve dhe Politikat Rinore.

Këshilli Nismëtar është një grup joformal që ka për qëllim të konsultojë të rinjtë dhe të përfaqësojë interesat e tyre në krijimin e Këshillit. Numri i anëtarëve të Këshillit Nismëtar është pesë dhe vetëm ata anëtarë kanë rolin për të formuar Kuvendin Lokal të të Rinjve. Kohëzgjatja e KN-së është afatshkurtër dhe përfundon me thirrjen e Kuvendit të parë Lokal të të Rinjve. Komuna është e ngarkuar me përzgjedhjen e tyre, ndërsa puna e tij koordinohet dhe ndihmohet nga nëpunësi/ja për të rinjtë në komunë.

Roli dhe detyrat e Këshillit Nismëtar:

- Mbështetje për komunën në krijimin ose rishikimin e akteve dhe vendimeve që e rregullojnë krijimin dhe funksionimin e KRL-së;
- Shpallja e thirrjes për Kuvendin konstituiv Lokal të të Rinjve në përputhje me Statutin e komunës, sipas parimit të publicitetit dhe transparencës;
- Bashkëpunimi me komunën në organizimin dhe mbajtjen e Kuvendit konstituiv Lokal të të Rinjve.

KN mund të përfshijë organizata rinore, organizata për të rinjtë, forume rinore të partive politike, organizata të nxënësve dhe të studentëve dhe forma të tjera të organizimit rinor që veprojnë dhe funksionojnë në territorin e komunës dhe që duan të marrin pjesë në themelimin e Këshillit.

Dokumentet e detyrueshme:

- Portofoli i organizatës/grupit/shoqatës;
- Programi vjetor i punës;
- Raporti mbi aktivitetet me të rinjtë gjatë vitit të kaluar;
- Letër me emërimin për anëtar të Këshillit Nismëtar dhe informacione për kontakt;
- Letër e shkurtër motivuese nga anëtar i propozuar dhe biografi e shkurtër.

Mënyra e aplikimit:

E-maili:

Adresa:

Afati për aplikim:



# Shtojcë për Këshillin Rinor Lokal

## Shtojca 5 - Rregullore për Këshillin Rinor Lokal

### RREGULLORJA E PUNËS SË KUVENDIT LOKAL TË TË RINJVE

#### DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

##### Neni 1

Rregullorja e punës e rregullon mënyrën e punës dhe vendimmarrjen e Kuvendit Lokal të të Rinjve në komunën e XXX (në tekstin e mëtejshëm: KRL-ja e komunës së XXX).

##### Neni 2

Puna e Kuvendit Lokal të të Rinjve është publike dhe në të marrin pjesë të gjitha llojet e organizatave, në përputhje me Ligjin për Pjesëmarrjen e të Rinjve dhe Politikat Rinore, që kanë aplikuar në Thirrjen publike për pjesëmarrje në KRL-në e komunës së XXX.

Në Kuvend marrin pjesë format e organizimit që kanë aplikuar me delegatët e tyre.

Në Kuvend marrin pjesë edhe përfaqësues të komunës.

### MBLEDHJA KONSTITUIVE E KUVENDIT LOKAL TË TË RINJVE

##### Neni 3

Në mbledhjen konstituive të Kuvendit Lokal të të Rinjve të komunës së XXX, zgjidhet një kryesues/e nëpërmjet votimit të fshehtë. Secili anëtar i Kuvendit të të Rinjve mund të kandidojë për kryesues/e ose nëse propozohet dhe mbështetet nga të paktën tre anëtarë të Kuvendit të të Rinjve.

Mandati i anëtarëve të Kuvendit Lokal të të Rinjve, duke përfshirë edhe kryesuesin/en, zgjat për dy vjet me të drejtë për t'u zgjedhur edhe një herë.


Kryesuesi/ja është përfaqësuesi/ja kryesor/e i/e Kuvendit Lokal të të Rinjve. Kryesuesi/ja udhëheq dhe kryeson me Kuvendin Lokal të të Rinjve, e përfaqëson atë në organet e komunës, i ndjek udhëzimet e anëtarëve të Kuvendit në punën e tij.

Anëtarët (delegatët dhe delegatet) punojnë në zbatimin e aktiviteteve të KRL-së, marrin pjesë në përgatitjen e dokumenteve dhe aktivitete të tjera.

### TË DREJTAT DHE DETYRAT E DELEGATIT

##### Neni 4

Delegati ka të drejtë dhe detyrë të marrë pjesë në KRL dhe të marrë pjesë në punë dhe në vendimmarrje.



Delegati i cili është i penguar të marrë pjesë në Kuvend, është i detyruar ta informojë kryesuesin deri në fillim të seancës së KRL-së.

Për praninë e delegatëve mbahet një fletë evidentuese, e cila është e hapur gjatë seancës.

Para përcaktimit të rendit të ditës, miratohet procesverbali nga seanca e mëparshme e Kuvendit.

Delegatët mund të japin vërejtje në lidhje me procesverbalin dhe të kërkojnë që të bëhen ndryshime dhe plotësime adekuate në të.

Kryesuesi i Kuvendit konstaton se është miratuar procesverbali në të cilin nuk janë bërë vërejtje, gjegjësisht procesverbali në të cilin janë bërë ndryshime dhe plotësime.

## ORGANET PUNUESE TË KUVENDIT

### Neni 5

Pasi të përcaktohet kuorumi, me propozimin e kryesuesit/es, Kuvendi zgjedh:

- Komisionin e Verifikimit - i cili përbëhet nga tre anëtarë nga delegatët, njëri/a prej të cilëve është kryetar/e i/e komisionit;
- Protokollist dhe dy vërtetues të procesverbalit; dhe
- Organe të tjerë të punës për të cilët Kuvendi do të vendosë se janë të nevojshme.

## VENDIMMARRJA

### Neni 6

Kuvendi do të punojë dhe do të vendosë në mënyrë të vlefshme nëse janë të pranishëm 50% plus një nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Kuvendit.

Kryetari/ja i/e Komisionit të Verifikimit i thërret delegatët që ta konfirmojnë praninë e tyre dhe e përcakton numrin e tyre.

Vendimet merren me shumicën e votave të delegatëve të pranishëm. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë.


Secili delegat ka të drejtë për një votë.

### Neni 7

Të gjitha vendimet votohen publikisht, përveç zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Rinor Lokal.

Zgjidhen ata kandidatë që kanë numrin më të madh të votave, me kusht që numri i përgjithshëm i votave për të gjithë kandidatët të jetë më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të pranishëm në Kuvend. Votimi publik kryhet duke përdorur mjete teknike. Delegatit/es i jepet një fletëvotim.

Kuvendi mund të vendosë që votimi të bëhet me votim të fshehtë me propozim të kryesuesit/es ose të një delegati/eje, kërkesa e të cilit/cilës do të votohet nga Kuvendi.



Votimi i fshehtë zhvillohet me fletëvotime. Fletëvotimet duhet të kenë madhësinë e njëjtë. Emrat dhe mbiemrat e kandidatëve renditen individualisht në fletën e votimit, sipas rendit alfabetik të mbiemrave të tyre.

Kryesuesi/ja është i/e detyruar që gjatë votimit të sigurojë kushte për zhvillimin e votimit të fshehtë.

Fleta e votimit konsiderohet e pavlefshme, nëse prej saj nuk mund të përcaktohet me siguri se për cilin kandidat ka votuar delegati/ja.

#### Neni 8

Secili kandidat që kandidon për ndonjërin prej pozicioneve ka të drejtë të bëjë një prezantim të shkurtër para delegatëve/eve.

#### Neni 9

Pas zgjedhjeve të konfirmuara, Komisioni i verifikimit i Kuvendit Lokal të të Rinjve përgatit një raport/procesverbal me listën e anëtarëve të zgjedhur, i cili miratohet nga Kuvendi Lokal i të Rinjve dhe i dorëzohet Këshillit të komunës për verifikimin e mandateve të tyre.

#### Neni 10

Çdo anëtar i zgjedhur i Këshillit Rinor Lokal mund të revokohet nga ana e Kuvendit, me propozimin e një delegati/eje të Kuvendit dhe pas zbatimit të aktit të votëbesimit.

Kuvendi mund të revokojë një anëtar individual, ose t'i revokojë të gjithë anëtarët e Këshillit Rinor Lokal, në mënyrë kolektive.

Kuvendi vendos për një iniciativë të tillë me shumicën e parashikuar në Rregulloren e punës.

### PROCESVERBALI

#### Neni 11


Për punën e seancës së Kuvendit Lokal të të Rinjve mbahet procesverbal.

Procesverballi i përmban të dhënat themelore për punën e seancës, emrat e të pranishmëve, propozimet, qëndrimet e organit punues, rezultatet e secilit votim, që janë parashtruar dhe përfundimet që janë miratuar në lidhje me pikat e rendit të ditës.

Kryesuesi i KLR-së, protokollisti dhe dyvërtetues të procesverbalit e nënshkruajnë procesverbalin dhe janë përgjegjës për vërtetësinë e tij.

Anëtarët e Këshillit Rinor Lokal dhe nëpunës/ja për të rinjtë në komunë kujdesen për përgatitjen e procesverbalit dhe ruajtjen e origjinalit të procesverbalit nga seancat.





## **Shtojca 6 – Vendimi për zgjedhjen e anëtarëve nga ana e Kuvendit Lokal të të Rinjve për anëtarë të Këshillit Rinor Lokal**

Deri te: Emri dhe mbiemri

Këshilli i komunës së XXX

### V E N D I M

Kuvendi Lokal i të Rinjve më datë \_\_\_\_\_, mbajti një takim në të cilin u zgjodhën anëtarët e Këshillit Rinor Lokal të komunës së XXX.

Në bazë të Vendimit me numër \_\_\_\_\_ të komunës së XXX për krijimin e Këshillit Rinor Lokal dhe në përputhje me Rregulloren e punës të Kuvendit Lokal të të Rinjve neni X, Kuvendi Lokal i të Rinjve mori vendimin si më poshtë:

Për anëtarë të Këshillit Rinor Lokal për periudhë dy vjeçare, gjegjësisht nga \_\_\_\_\_ (data) deri më \_\_\_\_\_ (data) u zgjodhën:

1. Emri dhe mbiemri, organizata
2. Emri dhe mbiemri, organizata
3. Emri dhe mbiemri, organizata
4. Emri dhe mbiemri, organizata
5. Emri dhe mbiemri, organizata
6. Emri dhe mbiemri, organizata
7. Emri dhe mbiemri, organizata
8. Emri dhe mbiemri, organizata
9. Emri dhe mbiemri, organizata

Mandati i anëtarëve të Këshillit Rinor Lokal të komunës së XXX zgjat 2 vjet.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e verifikimit të anëtarëve nga Këshilli i komunës së XXX, (data).

Data dhe vendi

Kryesuesi/ja i/e Kuvendit Lokal të të Rinjve  
Emri dhe mbiemri dhe nënshkrimi





- Rregullorja e punës;
- Përgatitja e propozim-programit të Këshillit Rinor Lokal;
- Promovimi i Këshillit Rinor Lokal te të rinjtë e komunitetit lokal;
- Caktimi i mbledhjes së ardhshme...

Një anëtar i grupit shtoi një pikë tjetër në rendin e ditës për mënyrën e komunikimit me komunën.

Propozimi për plotësimin e rendit të ditës me këtë pikë u votua dhe ai u miratua me të gjitha votat "Për".

**VOTUAN: PËR – X KUNDËR – X ABSTENUAN – X**

U konstatua se rendi i ditës për mbledhjen e parë është miratuar.

Për pikën E PARË në rendin e ditës u diskutua për Rregulloren e propozuar të punës. Gjatë diskutimit, u bisedua dhe u përcaktuan përgjegjësitë e kryetarit/es dhe zëvendësit/es. Pas diskutimit u miratua Rregullorja e propozuar e punës.

**VOTUAN: PËR – X KUNDËR – X ABSTENUAN – X**

**Shembull:** Për pikën **E DYTË** në rendin e ditës u diskutua për nevojën për të krijuar programin e punës. Caktohet një datë për një takim gjithë ditën të anëtarëve së bashku me koordinatorin për planifikimin e programit. Personi XX sugjeron dy mënyra për t'i konsultuar të rinjtë për krijimin e programit të punës për vitin e ardhshëm.

**Shembull:** Për pikën **E TRETË** në rendin e ditës u diskutua në lidhje me mënyrat për të promovuar Këshillin Lokal, edhe atë si në internet ashtu dhe drejtpërdrejt përmes mediave lokale, pastaj në lidhje me krijimin e logos dhe materialeve promovuese.

**Shembull:** Për pikën **E KATËRT** në rendin e ditës u ra dakord që takimi të mbahet më — (data).



Të gjitha pikat e rendit të ditës u diskutuan.  
Me këtë mbaroi takimi i parë i Këshillit Rinor Lokal.

Kryetari/ja i/e Këshillit Rinor Lokal  
XXXX



#### Neni 5

Anëtari i KRL-së, i cili për shkaqe të arsyeshme nuk mund të marrë pjesë në seancë, është i detyruar ta informojë kryetarin/en në kohë. Nëse një anëtar nuk mund të marrë pjesë në seanca për një kohë të gjatë, ai/ajo është i/e detyruar ta informojë kryetarin/en dhe për këtë të kërkojë aprovim të veçantë, për të cilin KRL-ja do të vendosë veçmas, në përputhje me Statutin dhe Vendimin për themelimin e KRL-së.

#### Neni 6

Anëtari i KRL-së është përgjegjës për përfaqësimin dhe zbatimin e qëndrimeve të KRL-së, dhe ka për detyrë t'i informojë anëtarët e KRL-së (kryetarin/en, nënkryetarin/en) për kryerjen e të gjitha detyrave që i janë besuar.

#### Neni 7

KRL-ja zakonisht mban mbledhje të paktën një herë në muaj. Si përjashtim, për shkak të urgjencës për të vepruar në aktivitete të caktuara, kryetari/ja mund të vendosë që seanca të mbahet brenda një periudhe më të shkurtër kohore.

#### Neni 8

Gjatë punës së Kuvendit Rinor Lokal mbahet procesverbal. Procesverbali i përmban të dhënat themelore për punën e seancës, e veçanërisht konkluzionet, vendimet dhe zgjidhjet e miratuara në seancë me rastin e shqyrtimit të çështjeve në rendin e ditës. Procesverbali u dërgohet anëtarëve të KRL-së me ftesën për seancën e ardhshme. Në fund të procesverbalit gjenden deklaratat e secilit prej anëtarëve të Komisionit me të cilat ata i konfirmojnë rezultatet e votimit, gjegjësisht procesverbali nënshkruhet nga të gjithë anëtarët që kanë votuar.

#### Neni 9

Procesverbali miratohet në fillim të seancës së ardhshme. Gjatë miratimit të procesverbalit, secili anëtar i KRL-së ka të drejtë të japë vërejtje mbi procesverbalin. Për vërejtjet që do të miratohen, bëhet korrigjimi i procesverbalit.

#### Neni 10

Ndryshimi dhe plotësimi i kësaj Rregulloreje të punës do të bëhet në mënyrën dhe procedurën sipas të cilës miratohet.

#### Neni 11

Kjo rregullore e punës hyn në fuqi në ditën e miratimit.

Data dhe vendi

Kryetari/ja i/e  
Këshillit Rinor Lokal të komunës së XXX







## Qëllimi 2: XXX

- **Lista e aktiviteteve të implementuara:**

- o **Aktiviteti 1:**

- Emri i aktivitetit
    - Përshkrimi dhe qëllimet e aktivitetit
    - Rezultati i arritur
    - Informacion sasior (numri i pjesëmarrësve, numri i shpërndarjeve, numri i takimeve, aktorët që janë të përfshirë...)

- o **Aktiviteti 2:**

- Emri i aktivitetit
    - Përshkrimi dhe qëllimet e aktivitetit
    - Rezultati i arritur
    - Informacion sasior (numri i pjesëmarrësve, numri i shpërndarjeve, numri i takimeve, aktorët që janë të përfshirë...)

- **Anët e forta në kuadër të zbatimit të këtij qëllimi**

- **Anët e dobëta në kuadër të zbatimit të këtij qëllimi**

- **Propozime për aktivitete vijuese për programin e ardhshëm vjetor**

Shtojca:



Në shtojca mund të shtoni disa dokumente ose rezultate shtesë, të cilat janë zhvilluar gjatë vitit. Për shembull, nëse keni zhvilluar ndonjë politikë specifike për të rinjtë (për shembull, një strategji lokale për të rinjtë), mund ta shtoni në pjesën e shtojcave.







CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

352.075-053.6(035)

352.077-053.6(035)

DORACAK për këshillat rinore lokale / [autorë/e: Jasmina Todorovska-Miteva ... [и др.]; bashkëpunëtorë/e: Mirije Sulmati dhe Goran Tanevski]. - Shkup : Agjencia për rini dhe sport dhe misioni : Misioni i OSBE-së në Shkup, 2021. - 81 стр. : табели ; 21 см

Фусноти кон текстот. - Други автори: Nina Shulloviç-Cvetkovska, Dona Kosturanova, Bllazhen Maleski, Tomislav Gajtanoski, Lindita Rexhepi, Matej Manevski, Zoran Ilieski. - Библиографија: стр. 59. - Содржи и: Shtojça

ISBN 978-9989-2266-6-3 (AKRL)

ISBN 978-608-4788-64-5 (OSBE)

1. Todorovska-Miteva, Jasmina [автор] 2. Shulloviç-Cvetkovska, Nina [автор] 3. Kosturanova, Dona [автор] 4. Maleski, Bllazhen [автор] 5.

Gajtanoski, Tomislav [автор] 6. Rexhepi, Lindita [автор] 7. Manevski, Matej [автор] 8. Ilieski, Zoran [автор]

а) Локална самоуправа – Младински совети – Прирачници б) Локална самоуправа – Креирање политики – Млади – Прирачници

COBISS.MK-ID 53944325



**Misioni i OSBE-së në Shkup**  
Bulevardi 8 shtatori Nr. 16, 1000 Shkup

e-mail: [info-MK@osce.org](mailto:info-MK@osce.org)  
website: <http://www.osce.org/mission-to-skopje>